



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:023994

Datë: 27.06.2023

Numri i dokumentit: 04431544

PKR.nr. 361/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Krime të Rënda, Trupi gjykues në përbërjet prej, Kryetarit të trupit gjykues Ngadhnjim Arni dhe anëtarëve të trupit gjykyes – gjyqëtarëve profesional Medije Bytyqi dhe Agim Kuqi, me zyrtarën ligjore Kaltrina Qollaku, në çështjen penale ndaj të akuzuarve H. Sh. dhe A. B. që të dy nga Komuna e D.it, për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë në bashkëkryerje nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi 06/L-074), tutje (KPRK), si dhe secili veç e veç për veprën penale Mbajtja në pronësi apo posedim të pa autorizuar të armës nga neni 366 paragrafi ti i KPRK-së, e po ashtu edhe ndaj të akuzuarit A. B. për shkak të veprës penale Pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.97/21 të datës 15.06.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, të mbajtur me datë 11.05.2023, në prezencën e Prokurorit të Shtetit – Departamenti për Krime të Rënda Besa Limani, të dëmtuarit F. Xh. me përfqësuesin e tij Avokat Gazmend Halilaj, të akuzuarit H. Sh., me mbrojtësin e tij me autorizim Avokat Hasan Jashari, të akuzuarit A. B. me mbrojtësin e tij me autorizim Ahmet Gjinovci, si dhe të akuzuarit A. B., me datë 15.05.2023 publikisht shpalli, ndërsa pas kërkësës për vazhdim të afatit për përpilimin e aktgjykimit, në afatin e lejuar ligjor, me datë 27.06.2023 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

H. Sh., i biri i H. dhe A., e vajzërisë M., i lindur me datë //, në fshatin K. Komuna- D. ku edhe jeton, i pamartuar, ka te kryer shkollën e mesme, punëtor fizik, me numër personal, //, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

A. B., i biri i R. dhe K., e vajzërisë V., i lindur me datë //, në fshatin T. Komuna D., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, //, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

I.Me datë 05.02.2021, rreth orës 12:55 min, në rrugën “**Ilaz Kodra**” në D., pas një mosmarrveshje paraprake në mes të akuzuarve H. Sh. dhe A. B. në njërën anë dhe të dëmtuarit F. Xh. në anën tjetër, derisa i dëmtuari – dëshmitari F. Xh. ka qenë me shokun e tij - dëshmitarin E. Xh. duke ecur në drejtim të Stacionit të Autobusave në D., në ato qaste i është afruar i akuzuari H. Sh. i cili e ka ndjekur nga pas nga njëra anë dhe kur ka arritur tek Stacioni i Autobuseve, i akuzuari A. i cili po ashtu ka qenë duke e ndjekur nga ana tjetër, u ka dalur përpara dhe ju ka thënë “F. ndalu” me ç’ rast i dëmtuari F. me dëshmitarin E. janë ndalur dhe kanë filluar të diskutojnë lidhur me një problem, ndërkohë ka mbri edhe i akuzuari H. me 7-8 persona të pa-identifikuar i cili është drejtuar me fjalët: “pse ma ke nguc nipin” dhe e ka goditur me shuplak në fytyrë të dëmtuarin F. i cili është munduar të vetëmbrohet, ndërkohë dëshmitari E. është munduar që ti ndaj dhe e ka kapur të akuzuarin H. i cili e ka nxjerrë thikën dhe deri sa i dëmtuari F. ishte vet dhe duar thatë, fillimisht i pari i akuzuari A. B. ka nxjerrë po ashtu thikën dhe me dashje që ta privoj nga jeta e ka goditur me thikë në qafë të dëmtuarin F., e po ashtu i akuzuari H. pasi që është liruar nga dëshmitari E., me dashje që ta privoj nga jeta e ka goditur po ashtu me thikë në qafë të dëmtuarin F., mirëpo ndërkohë deri sa ishte duke vazhduar perleshja, ka arritur Policia duke bërë titur, “largoni thikat”, dhe vepra penale ka mbetur në tentativë, ndërsa i dëmtuari ka pësuar lëndime të rënda trupore, plagë prerëse në regjionin e qafës, enfizem e lehtë subkutane, prishje e kontunitetit të indeve të buta, submandibulare të qafës dhe skajit të poshtëm të gjandres pshtymore submandibulare të majtë, lëndime këto të shkaktuara si rezultat i veprimit mekanik të mejtit të fortë dhe të mprehtë.

Me këto veprime, të akuzuarit e lartçekur në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale:

Vrasja në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe nenin 31, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

II. I akuzuari H. Sh., me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e lartçekur, ka mbajtur në pronësi armën-thikë të tipit patent, e të cilën e ka mbajtur në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët nr.05/L – 022.

Me këto veprime, i akuzuari i H. Sh. ka kryer veprën penale:

Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

III. I akuzuari A. B., me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e lartçekur, ka mbajtur në pronësi armën-thikë të tipit patent, e të cilën e ka mbajtur në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët nr.05/L – 022.

Me këto veprime, i akuzuari i A. B. ka kryer veprën penale:

Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata konform neneve: 4, 7, 17, 38, 39, 40, 42, 70, 76, 79, të KPRK-së, si dhe neneve, , 360, 364 dhe 366 KPPRK-së, të akuzuarve H. Sh. dhe A. B. u:

PËRCAKTON

Për veprën penale nga dispozitivi i parë (I), secilit veç e veç dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej tetë(8)vite.

Për veprën penale nga dispozitivi i dytë (II), të akuzuarit H. Sh. dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, e po ashtu për veprën penale nga dispozitivi tre (III) të akuzuarit A. B. dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj.

Konform nenit 76 të KPRK-së gjykata të lartcekurit secilin **veç e veç** i gjykon me:

DËNIM UNIK ME BURGIM

Ashtu që të akuzuarit **H. Sh.** dhe **A. B.**, për veprat penale nga dispozitivi I, II dhe III, secilin **veç e veç** i gjykon me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej **8 (tetë) vite e 1 (një) muaj** burgim, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Gjykata me aktvendim të posaçëm, ka vazhduar masën e paraburgimit për të dy të akuzuarit e lartcekur deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar, ku koha e kaluar nën masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak prej datës 08.02.2021, do tu llogaritet në dënimin e lartcekur me burgim.

Obligohen të akuzuarit H. Sh. dhe A. B., që në emër të shpenzimeve të procedurës, secili **veç e veç** të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)**, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit po ashtu secili **veç e veç** shumën prej **50.00€ (pesëdhjetë euro)**, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari F. Xh., lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet ne kontest të rregullt juridiko civil.

I akuzuari:

A. B., i biri i H. dhe S., e vajzërisë N., i lindur me datë //, në fshatin T. Komuna D., me vendbanim në rr “ //” numër //, i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes se mesme ekonomike, me numër personal //, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Sepse:

IV. I akuzuari A. B. ka marr pjesë në rrahje që ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor të të dëmtuarit-dëshmitarit F. Xh., në atë mënyrë që me datën dhe vendin e përcaktuar si në dispozitivët e lartshënuar, pas një mosmarrëveshje paraprake në mes të akuzuarve H. Sh. dhe A. B. në një anë dhe të dëmtuarit F. Xh. në anën tejtër deri sa të akuzuarit, i dëmtuari dhe persona të tjerë të pa identifikuar ishin duke u perleshur mes vete dhe i dëmtuari ishte i goditur me thikë nga të akuzuarit e lartcekur, në rrahje ka marrë pjesë edhe i akuzuari A. B. i cili e ka goditur me grushte të dëmtuarin F. Xh..

Me këto veprime i akuzuari A. B. ka kryer veprën penale:

Pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Gjykata në pajtim me nenet: 4, 7, 17, 23, 38, 46, 47, 48, 70, të KPRK-së, si dhe në pajtim me nenet: 360, 364 dhe 365, të KPPRK-së, të akuzuarit të lartcekur i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

I. Të akuzuarit A. B., i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, dënim i cili nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej dy (2) vite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në qoftë se i njëjti nuk kryen veprë të re penale.

II. Obligohet i akuzuari i lartcekur, që në emër të shpenzimeve të procedurës, të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **50€ (pesëdhjetë euro)**, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit po ashtu shumë prej **50€ (pesëdhjetë euro)**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. I dëmtuari F. Xh., lidhur me kërkesën pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Historiku i procedurës dhe pretendimet e palëve në procedurë

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të rënda, ka paraqitur aktakuzën PP/L.nr.97/21 e datës 15.0.2022, ndaj të akuzuarve H. Sh. dhe A. B. që të dy nga Komuna e D.it, për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë në bashkëkryerje nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi 06/L-074), tutje (KPRK), si dhe secili veç e veç për veprën penale Mbajtja në pronësi apo posedim të pa autorizuar të armës nga neni 366 paragrafi 1 të i KPRK-së, e po ashtu edhe ndaj të akuzuarit A. B. për shkak të veprës penale Pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-së.

Kompetenca e gjykatës

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështrimin e aktakuzës ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore.

Sa i përket kompetencës territoriale gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i KPPRK-së, kompetencë teritoriale për tu gjykuar një çështje juridiko-penale, ka gjykata në territorin e së cilës është kryer apo është tentuar të kryhet vepra penale, apo në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja. Në rastin konkret vepra penale është kryer në D. që bie nën kompetencën teritoriale të Gjykatës Themelore në Prishtinë, andaj Gjykata Themelore në Prishtinë ka kompetencën teritoriale në gjykimin e kësaj çështje.

Duke vlerësuar kompetencën lëndore, gjykata konstaton se vepra penale e Vrasjes është përcaktuar si krim i rëndë me nenin 22 të KPPRK-së, andaj gjykata konstaton se Departamenti për Krime të Rënda ka kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje.

Shqyrtimi gjyqësor

Kjo gjykatë fillimisht konstaton se në rastin konkret të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm për veprat penale për të cilat akuzohen në shqyrtimin fillestar, ndërsa tutje kërkesat e tyre për hedhjen e akuzës të parashtruara nga mbrojtësit e tyre ishin refuzuar, me ç' rast ishte urdhëruar caktimi i shqyrtimit gjyqësor. Shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale kishte filluar rishtazi për faktin se kishte ardhur deri tek ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues.

Me rastin e fillimit rishtazi të këtij shqyrtimi gjyqësor, në deklarimin e tyre të akuzuarit ishin deklaruar te pafajshëm për të gjitha pikat e akuzës, andaj kjo gjykatë kishte proceduar tutje me rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor duke kaluar në fjalën hyrëse.

Fjala hyrëse e palëve

Prokurori i shtetit, në fjalën hyrëse ishte deklaruar si vijon: ne këtë çështje penale mbetëm pranë fjalës hyrëse të dhënë në shqyrtimin e kaluar dhe tani për tani nuk kam se çka të shtoj tjetër.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar Avokat Gazmend Halilaj ne fjalën e tij hyrëse ishte deklaruar si vijon: e përkrahim në tërësi fjalën hyrëse të prokurorit të shtetit, po ashtu qëndrojmë pranë deklaramëve të dhëna në seancat e kaluara dhe tani theksojmë se në mënyre të plotë qëndrojmë prapa ndjekjes penale e natyrisht paraqesim edhe kërkesën parësorë juridike.

I dëmtuari F. Xh. ne fjalën e tij hyrëse ishte deklaruar si vijon: e mbështes fjalën e përfaqësuesit tim dhe nuk kam se çka të shtoj tjetër.

Avokat Hasan Jasharri mbrojtës i të akuzuarit H. Sh. në fjalën e tij hyrëse ishte deklaruar si vijon: ne fjalën hyrëse e kemi dhënë në shqyrtimin gjyqësor, respektivisht në procesverbalin që gjendet ne shkresa të lëndes andaj, nuk e shoh të arsyeshme të përsëriten edhe një herë çështjet e specifikuar. Si mbrojtës i të akuzuarit mbes në tërësi pranë fjalës hyrëse të dhëna ne seancat e kaluara duke shtuar se jam i bindur se me provat që janë në shkresa të lëndes do të vërtetohet pafajësia e të mbrojturit tim për dy veprat penale.

I akuzuari H. Sh. në fjalën e tij hyrëse ishte deklaruar si vijon: e mbështes në tërësi fjalën e avokatit tim dhe skam çka të shtoj tjetër.

Avokat Ahmet Gjinovci në fjalën e tij hyrëse ishte deklaruar si vijon: mbes në tërësi pranë fjalës hyrëse si në seancën e kaluar dhe mendoj se gjatë seancave të radhës do të vërtetohet pafajësia e të mbrojturit tim.

I akuzuari A. B. ne fjalën e tij hyrëse ishte deklaruar si vijon: e mbështes fjalën hyrëse të avokatit tim nuk kam se çka te shtoj tjetër.

I akuzuari A. B. në fjalën e tij hyrëse ishte deklaruar si vijon: pretendoj se në këtë shqyrtim gjyqësor do te vërtetohet pafajësia ime.

Procedimi i provave personale

Gjykata në vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 20.10.2022, kishte dëgjuar të dëmtuarin në cilësi të dëshmitarit F. Xh..

Në cilësi të dëshmitarit F. Xh. ishte deklaruar si vijon:

1.Dëshmia e dëshmitarit F. Xh.: ditën kritike kame qene ne kafene “ //” ne G. me E. Gj. dhe se në atë kafene me aq sa i kujtohet ka qëndurar për afërsisht rreth 30 minuta deri ne 1 ore ishim ne kafe. H. Sh. ka ardhur me një shok te tij i cili na ka këqyr mrrolte, personi qe na ka këqyrë mrrolte ka qen i akuzuari H.. Me pas H. ka dal nga kafeneja e po ashtu pas rreth 10 minuta kemi dal edhe un me shokun tim E.. Lidhur me faktin se kur kanë dalë nga lokali i dëmtuari në cilësi të dëshmitarit ka rrëfyer se na nuk e kemi vërejtur se nga është duke shkuar H. por siç e ceka jemi ngritur pas 10 minuta kur ka dal aji. Gjate rrugëtimit për tek stacioni i autobusëve kemi vërejtur se H. dhe shoku i tij kane qen te ndalur rreth 100 apo 200 metra larg lokalit qe kemi qen ne dhe pasi kemi kaluar dy –tre hapa para tyre H. dhe shoku i tij ka ardhur pas neve e ku te njëjtit na kane ndjekur nga pas dhe ne kemi ndryshuar kahjen për ne stacion dhe ne aty kemi hyre në anën e majtë te rrugës ku është parkingu i banesave, e ku H. dhe shoku i tij ka vazhduar drejte për tek lokalet qe i bie ne anenë e djathte ku të njëjtit kane ecur paralele me neve. Mbasi qe ne kemi arrit tek rampa e autobusëve A. B. dhe disa shoke te tije i kemi takuar tek rampa dhe me ka thënë F. ndalu, pastaj ne jemi ndalur ne ato momente ka ardhur H. Sh. i cili me është drejtuar me fjalët “ pse ma ke nguc nipin”.., ne i kemi thënë se nuk ta kemi nguc nipin dhe as nuk e njohim nipin. Ne ato momente H. me ka goditur me shuplak pastaj ka filluar përleshja, ku A. dhe shokët e tij kane intervenuar njëjte si H. te cilët kane pasur nga një thike ne dore secili prej tyre veç e veç. Duke ju përgjigjur pyetjeve të prokurores së shtetit lidhur me veprimet e te akuzuarve në momentet kritike, dëshmitari ka specifikuar: gjatë kohës kur isha ne tubën e njerëzve kam vërejtur se A. me ka goditur nga ana e majtë e qafës, për te qen me i qarte me ka goditur nga ana e majtë e qafës, i cili edhe e ka ngreh thikën, e kam fjalën qe kur A. me ka goditur me thike ne qafës e ka ngreh thikën përreth qafës sime, A. ka qen prapa meje, nga mbrapa me ka goditu me thike dhe e ka tërhequr thikën nga poshtë larte ne qafen time (në fyt). Pastaj un ne ato momente kam vërejtur se gjate shmangies se përleshjes pastaj H. Sh. me ka goditur prej larte poshtë ne qafe me thike pak mbi qafen time respektivisht ne nofull, e ku ju mund ta shini edhe shenjen time.

Un kam vërejtur se te dyte me kanë goditur nga një herr me thike për veprimet te cilat i ceka me herret.

Gjate përleshjes policia ka qen duke ardhur ne këmbe aty afër dhe na kane pare duke u përleshur, dhe policet kane bër titur policia policia, pastaj te njëjtit janë shpërnda.

E. ka qen me mua por gjate përleshjes un nuk kam mundur ta vërej se ku ka qen E..

Sa i përket të akuzuarit A. ka specifikuar se gjate përleshjes kame vërejtur A. B. i cili me ka goditur me grushte dhe se këto goditje i ka marr pasi që të akuzuarit e lartcekur e kanë goditur me thikë. Me grushte me kane goditur edhe persona te tjerë pra shokët e tyre, ndërsa me thike vetëm i akuzuari H. dhe A.. Pasi qe me kane goditur secili veç e veç me thike un e kam vërejtur se H. ka shtyre shokët e tij duke ardhur përsëri ne drejtimin tim me thike ne dore, po ashtu njëjtë

ka vepruar edhe A.. Ne ato momente arsyeja pse te njëjtit nuk kane arrit te me godasin prape eshë, sepse në vendin e ngjarjes ka arritur policia dhe kane bërë titur policia policia.. dhe turma është shpërndare dhe ka sqaruar se gjithçka ka ndodhur shume shpejte ndoshta ne një përudhë prej 10-20 sekonda.

Për gjatë shqyrtimit gjyqësor, ishte arritur të sigurohet edhe prania e dëshmitarit E. Gj..

Në cilësi të dëshmitarit E. Gj. ishte deklaruar si vijon:

2.Dëshmia e dëshmitarit E. Gj.: ditën kritike kam qen në D., dhe kam qen me F., me saktësisht kemi qen në kafën “//” dhe aty kemi qëndruar rreth 20-30 minuta. Me neve ka qen edhe nje kojshi i joni me emrin R. K.. I njëjti nuk ka qëndruar shume dhe ka shkuar. Tutje kur ka ardhur H. na ka jap një shikim te mrrrolshëm ne drejtim tonin, pastaj H. i cili ka qen vet i treti ka dal nga lokali. Po ashtu shtoj se nuk e di se me kënd ka qen H.. H. ka dal nga lokali diku 4-5 minuta para neve, tutje ne kemi dal nga lokali për te ecur dhe kemi qen duke shkuar ne drejtim te Stacionit te autobusëve, pastaj e kemi par përsëri H. vet i treti tek kafja “//” dhe ne përderisa ishim duke ecur ne drejtim te stacionit te tret kane filluar te vin pas nesh. Duke shkuar tek stacioni ju qartësoj situatën qe A. ka qen me nje grup personash rreth 7 veta, ndërsa H. ka qen ne anën tjetër vet i treti. Nga njëra ane A. me grupin e vet dhe nga ana e tjetër H. me grupin e vet na kane bllokuar rrugën dhe na kanë shti ne rreth. H. ju drejtua F.it dhe tha “pse ma ke nguc nipin” ne i thamë cilin nip dhe nuk e dijm se e kemi nguc dikend. Dhe ne ato momente H. ja ka meshuar shuplak F.it dhe i kane nxjerr thikat, respektivisht thikat i kane nxjerr A. dhe H. Kur H. e ka nxjerr thikën un e kam kapur H. dhe i njëjti me ka thënë se lëshomë ose ta nguli edhe ty, ne ato momente un e kam lëshuar H., dhe H. ka shkuar ne drejtim te F. dhe e ka goditur me thike ne qafe, un kam qene duke u mbrojtur nga këta persona ne ato momente ka ardhur edhe A. i cili është përfshire ne rrahje dhe e ka goditur F.in i cili ka qen i therur. Për ta sqaruar situatën kur un e kam kapur H., A. ka shkuar ne drejtim te F., dhe ka qen A. i pari qe e ka goditur me thike F.in dhe pastaj ka rrjedh ngjarja siç e shpjegova, po ashtu edhe A. e ka goditur F. diku rreth qafës. Pastaj edhe persona tjerr qe kane qen me te e kane goditu F..

Un ne ato momente jam përleshur me A. dhe grupin e tyre me qëllimin e vetëm qe ta mbroje disi F. pasi qe te njëjtin e kam pasur si vëlla. Dikush nga te përfshirët ka bërë titur se e mbytet njërin dhe pastaj njeri person civil ka hyre për te na ndare dhe ne këto momente te njëjtit janë shpërnda, dhe pastaj ka ndërhyre edhe policia, po ashtu ka shtuar se nuk besoj qe këta persona ishin ndal po nëse nuk do te ndërhynte dikush.

Sa i përket te akuzuarit A. ka deklaruar se i njëjti eshte përfshi ne rrahje dhe se e ka pare A. duke e goditur F. me grushte në kokë.

Ne pyetjen e përfaqësuesit te palës se dëmtuar lidhur me thikat dëshmitari ka sqaruar: qe të dy të akuzuarit i kane pasur thikat e zeza boker. Këto thika janë dikun 15/20 cm e kane tehin, dhe te njëjtat qelën me pulle respektivisht ndryshe njihet si thika patent.

Në pyetjet e trupit gjykyes, dëshmitari ka sqaruar se: mbasi e ka goditur me shuplak F.in e ka shtyer F. H. dhe un e kam kapur H. dhe i njëjti e ka hapur thikën, kur un kam qen i kapur me H., A. ka vrapuar ne drejtim te F.it me thike ne dore dhe e kam pare momentin kur A. e ka goditur me thike F.. Tutje ka specifikuar se F. ka qenë i goditur diku rreth qafës dhe se periudha mes godijtes me thike e A. me të H. ka qenë dikun një periudhe shume e shkurtër, për afërsisht 5-6 sekonda. Ka sqaruar duke specifikuar se si e kam lëshuar un H. aj menjëherë ka kërcyer dhe e ka goditur me thike një herr ne qaf, e edhe ky e ka goditur rreth qafës, ndërsa sa i përket të akuzuarit A. ka specifikuar se e kam pare te akuzuarin A. qe ka ardhur dhe e ka goditur me grusht ne koke një herr F.. Un e kam pare vetëm një herr dhe nuk e di nëse e ka goditur me shume e po ashtu ka sqaruar se e gjithë ngjarja nga zgjatur rreth 40-50 sekonda.

Në kuadër të vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor është proceduar me dëgjimin e ekspertit mjeko ligjor Dr.Naim i cili për gjatë deklaramit të tij në mes tjerash ka deklaruar si vijon:

3.Deklarimi i ekspertit Dr.Naim Uka: sipas akte ekspertimit mjeko-ligjore me Nr reference PR-52 te bazuar ne dokumentacionin e çështjes, respektivisht te raporteve mjekësorë te lëshuar nga Klinika Emergjente dhe ajo e Otorologjise, është dhëne mendimi ne lidhje me kualifikimet e lëndimeve trupore për te dëmtuarin F. Xh., ku dëmtimi i vetëm trupore gjenden ne regjionin e majte te qafës, kurse dëmtime e tjera te cilat janë si pasoje e mekanizmit te veprimit janë te përmbledhura ne pasusin dy dhe tre te mendimit dhe si te tilla konsiderohen dëmtime ne shumes. E gjithë dokumentacioni mjekësorë dëshmon për ekzistimin vetëm një plage prerëse e cila është konstatuar ne regjionin e majte te qafës. Për sqarim eksperti i lartcekur ka specifikuar se mendimi është dhëne bazuar ne dokumentacionin e çështjes, rrjedhimisht un nuk i kam pare plagët.

Tutje në seancën gjyqësore, eksperti e ka shikuar vendin ku ka marr plagët i dëmtuari dhe ka specifikuar se ne shikimin e plagës e cila gjendet ne regjionin e poshtëm te nofullës se majte konstatohen vrahja kirurgjike ne baze te të cilave është e pa mundur qe te ndahen se cila është plaga e përpunuar ne mënyre kirurgjike, ndërsa sa i përket pasojave, ne raste te ngjashme kur kemi te bëjmë me dëmtime te renda trupore kualifikimi i pasojave ne shëndet behet ne një periudhe kohore tre deri ne gjashte muaj pas fillimit te trajtimit te dëmtimit, duke pasur parasysh periudhën kohore qe nevojitet për trajtimin e plagës. Ky kualifikim (mos kualifikim) është ber duke u bazuar ne konstatimin radiologjik te raportit mjekësor te lëshua nga klinika e Orisë ku është evidentuar emfizema e lehte supkutane – trashje e mureve te alveoleve gjendje kjo e cila pengon procesin e frymarrjes si dhe dëmtime tjera si : prishje e kontunitetit te indeve te buta supmandivulare (nen nofull) dhe skajit te poshtëm te gjëndrës pështymorë te majte, andaj ka mbetur qe pasojat ne shëndet te kualifikohen pasi te sigurohet raporti mjekësor nga vizitat kontrolluese mjekësore, te cilat un nuk i posedoj.

Lidhur me faktin po qe se ne rastin konkret kemi pasur te bej me një apo dy plagë eksperti ka dhënë sqarimet si vijon:

Bazuar ne raport me dy dëshmi pra raportin mjekësor dhe fotografit qe i kam para vetes si dhe bazuar ne faktin se ne raportet mjekësorë janë përshkruar karakteristikat një plage duke potencuar regjionin e plagës si dhe gjatësinë e plagës e cila është përshkruar afërisht 8 cm, si dhe mungesën e ndonjë përshkrimi tjetër te plagës shoqëruese si dhe dëshminë e tri fotografive ku shihet kjart një plage e hapur ne forme trekëndëshe me gjatësi e cila është e ngjashme me përshkrimin e plagëve, te raporteve mjekësorë, dhe ne mesin e te cilave është edhe fotografia e fundit e cila është realizuar pas intervenimit kirurgjik me formë horizontale dhe qe i përgjigjet gjatësisë te përshkruar ne raportin mjekësor.

Duke kërkuar sqarime shtese nga trupi gjykues Dr. Naim Uka ka specifikuar si vijon: nuk përjashtohet si mundësi, pra mundet me qen dy goditje ne te njëjtin vend dhe te formojnë një plage. Për te qene me i qarte dhe ju ti kuptoni procedurat qe ne i ndjekim dua t’ju sqaroj se gjatë procedurave mjekoligjore te autopsive te ndryshme si dhe konkretisht te autopsive ku ka lëndime dëmtime te shkaktuara nga veprimi mekanik i majës dhe tehit te mjetit te forte, ne si mjek ligjore kemi përparësinë e kohës për eksplorimin dhe ekzaminimin e detajuar te vendit te dëmtuar ku e bëjmë përshkrimin e sakte duke ber edhe matjet e gjatësisë, gjerësisë, dhe thellësisë se plagës-plagëve te cilat shoqërohen pastaj edhe me fotografi. Ndërsa ne klinikat e SHSUK-se atë Emergjente dhe te gjitha klinikat kirurgjike është çështje e faktorit kohe ne trajtimin e rasteve urgjente ku rrezikohet jeta e te dëmtuarit gjithmonë mbetet prioritet intervenimit mjekësor me qellim te shpëtimit te jetës, kurse si detyre sekondare mbetet përshkrimi i karakteristikave te dëmtimit. Edhe intervenimi mjekësorë- drenazhe krijohet me veprimin e tehut te një skalperi qe është mekanizëm mprehës i ngjashëm me atë te thikës, mirëpo me qëllime mjekësorë, prandaj si përfundim mund te konkludoj se edhe vrahja qe përpunohet me qellim te intervenimit kirurgjik

shkaktohet me mekanizmin e njëjte, e qe rrjedhimisht ato nuk mund te dallohen njëra nga tjetra sepse janë identike.

Eksperti ka sqaruar edhe dallimet qe mund te jenë në mes të raporteve të kirurgëve dhe mjeko-ligjorëve duke specifikuar se: Për sqarimin e juaj ky dallim bazohet ne faktin, sepse kirurget kane për qellim qe me urgjence te shpëtojnë jetën, ndërsa ne si mjek ligjore qëllimi yni i vetëm është konstatimi, kualifikimi i dëmtimeve dhe pasojave në shëndet. Pra sikurse të ishte bërë një ekzaminim direkt do te kishte mundur te këtë dallime. Krejt në fund lidhur me faktin se plagët që ka marr i dëmtuari a kanë mundur të jenë vdekje-prurese, eksperti ka specifikuar se: plaga e konstatuar ne akt ekspertimin mjeko-ligjor ka te beje me një regjion te ndjeshëm për jetën e te dëmtuarit, mirëpo fatmirësisht ne atë regjion nuk janë atakuar enët dhe strukturat vitale jetësore. Këto struktura janë afër plagës dhe sikurse ato te prekeshin do te ishin fatale për jete.

Përgjatë vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor është proceduar me dëgjimin e dëshmitarit Sh. S..

Dëshmitari Sh. S. për gjatë deklarimit të tije në shqyrtimin gjyqësor, në mes tjerash ka specifikuar si vijon:

4.Dëshmia e dëshmitarit Sh. S.: po jam ne dijeni se ka ndodhur përleshja mes tyre ne D. për faktin se un kam qen duke kaluar kah vendi i ngjarjes dhe rastësisht i kam pare qe është bërë një grumbull ku ka pasur shume vet ne atë grumbull, un nuk e kam pare saktësisht se si ka ndodhur rrjedha e ngjarjes, sepse kam pasur shume persona përpara dhe krejt çka kam pare aty kane qene disa njolla me gjak ne toke. Duke dhënë përgjigje në pyetjet mbrojtësit te te akuzuarit H. Sh. lidhur me pozitën – veprimet e të akuzarit H., dëshmitari është përgjigjur: pasi qe kam arritur ne vendin e ngjarjes ka pasur shume persona aty dhe nuk kam mundur te shoh se kush dhe çfarë veprime ka ndërmar, tutje ka sqaruar se ka vërejtur se të akuzuarit H. i ka rënë një telefon në tokë e po ashtu në ato momente e ka parë se të dëmtuarit i ka rrjedhë gjak, por nuk i ka parë veprimet e secilit pjesëmarrës pasi që ka qenë tollovi e madhe. Ka sqaruar se kur e ka parë të akuzuarin H. ka qenë diku rreth 2-3 metra largë të dëmtuarit F., por tutje nuk ka arritur ti shoh veprimet e tij pasi që ka pasur shumë njerëz të përfshirë. Dëshmitari po ashtu ka sqaruar se personat tjerë që kanë qenë të përfshirë në këtë rast nuk i ka njohur dhe se e ka njohur H., A. dhe F.in por jo edhe të tjerët, ndërsa ka specifikuar se edhe pse e ka parë të dëmtuarin me plagë me gjak nuk ka arritur të shoh momentet se kush e ka goditur.

Lidhur me veprimet e dy të akuzuarve të tjerë A. B. dhe A. B. dëshmitari ia specifikuar: e kam pare A.in ka qen ne grumbullin e njerëzve duke lëvizur po nuk kam arrit te vërej diçka me shume, ndërsa A. nuk e kam parë. Krejt në fund në pyetjen e kryetrarit të trupit gjykues se a e ka parë ndonjë moment kritik dëshmitari dhe se a është kuptuar saktë deklarata e tij se i njëjti nuk ka parë asnjë moment kritik, i njëjti ka specifikuar si vijon: po është e vërtet un nuk kam par asgjë.

Seanca e shqyrtimit gjyqësor ka vazhduar me dëgjimin e dëshmitarit E. S., i cili përgjatë dëshmisë së tij në shqyrtimin gjyqësor ishte deklaruar si vijon:

5.Dëshmia e dëshmitarit E. S.: lidhur me rastin që kishte ndodhur dëshmitari kishte theksuar se po jam ne dijeni, atë dite un kam mbaruar orët e mësimit dhe kam qen duk shkuar ne një kafe, kam par një grumbull njerëzish dhe jam afruar aty tek vendi i ngjarjes qe te shoh se çka po ndodhe, kur jam afruar aty e kam pare H., F., A. e po ashtu kane qene edhe disa persona te tjerë te cilët un nuk i kam njohur. Ne momentin kur un kam shkuar H. e ka goditur me shuplak F.in, pastaj F. e ka goditur H. me grushte, dhe ne mes këtyre dyve un me nuk kam pare asgjë. Largësia ime afërsisht mes meje dhe H. ka qen diku 1-2 meter, ndërsa me F. 3 deri ne 4 metra, H. e kam pasur ne anenë e majte ndërsa F. ne anenë e djathte. Lidhur me faktin se si kishte përfunduar përleshja i njëjti kishte sqaruar se: i kam dëgjuar disa persona qe kanë bërtitur policia, policia, por un nuk i kam pare policinë, dhe shumica e personave qe kane qen ne vend ngjarje kanë ikur

nga aty. Dëshmitari ka sqaruar se e ka parë edhe të akuzuarin A., por nuk i ka parë veprimet e tij e po ashtu e ka parë në turmë edhe të akuzuarin A.. Dëshmitari po ashtu ka specifikuar se ka pasur edhe persona tjerë të përfshirë në rrahje, por përveç A. A., H. dhe F. të tjerët nuk i ka njohur. Lidhur me momentet kritike në pyetjet e anëtarëve të trupit gjykues, dëshmitari është përgjigjur: un e kam pare vetëm një herr H. qe e ka goditur F. dhe pastaj e kam pare edhe atë tollovin qe e shpjegova në fund kur i kam pare disa persona duke u rrahur me grusht, ndërsa lidhur me faktin se kush ia ka shkaktuar plagët të dëmtuarit F., dëshmitari është përgjigjur: un nuk e kam pare se kush e ka goditur F. qe ka rrjedhur gjake, vetëm e kam pare te gjakosur ne qafe duke i rrjedh gjake.

Shqyrtimi gjyqësor kishte vazhduar me dëgjimin e ekspertit – Dr.Artan Haxhiu, i cili në deklaratën e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ishte deklaruar si vijon:

6.Deklarimi i Dr.Artan Haxhiu: Lidhur me të dëmtuarin F. Xh., Dr.Artan Haxhiu ka specifikuar se. Për rastin në fjale si emër nuk më u kujtojke përderisa erdha ne seancën e kaluar dhe e pashe fizikisht tani te dëmtuarin dhe mu rikujtua si fytyre, jo diçka me shume. Dr.Artan Haxhiu ka shikuar edhe në seancën gjyqësore plagën e tani të dëmtuarit dhe ka sqaruar se: Ne baze te shiqimit te plagës vërehet qe janë dy premje ne forme te shkronjës A, por e cila është e lidhur njëra me tjetrën ne menyre kontinuele. Ne si rast momentet emergjente gjithmonë bëjmë preparimin e plagës, ndaljen e gjakderdhjes dhe qepjen dhe nuk jemi te fokusuar ne çështje tjera private apo personale te pacientit, për faktin se ne ato raste ne jemi duke luftuar per te shpëtuar jetën e pacientit, andaj ky është fokusi jone kryesor dhe çështje tjera aty janë sekondare. Nga ana jone siq e thashë me herët është e pamundur me e dit sakte se a është goditur një here ne vazhdimësi te prerjes apo dy here, po ashtu ne jemi fokusuar vetëm e preparim te plagës, domethënë vërehen dy vija- prerje te plagës e qe janë te lidhura njëra me tjetrën. Ne nuk mund te vëmë një mendim përfundimtar se a kane qene një apo dy plage, për arsye te lartë cekura, por nuk përjashtohet asnjëra nga këto mundësi. Po me kujtohet pak qe ka qene plage e hapur me gjakderdhje, ku pastaj është bere ndërhyrja, komprimimi i enëve te gjakut dhe pastaj preparimi(do te thotë kur ne e gjejmë vendin ku është gjakos ne mënyre qe ta bëjmë lidhjen e tyre- ndaljen e gjakderdhjes) dhe ne fund qepja. Raste te tilla ne kemi me dhjetëra dhe qindra, andaj edhe nuk mund ti kujtoj detajet. Gjate ketyre lëndimeve ne qafe, gjithmonë është rreziku për jete shume i madh për shkak se ne qofte e lëndohen dy enët kryesore te medhaja, arterie karotiskomunis dhe vena jugollare- interne, gjakderdhja është shume e madhe qe mund te shkaktoj edhe humbjen e jetës, por ne rastin konkret për fatin e tij, tek ky rast nuk janë prekur ato ene te gjakut por vetëm enët e vogla te gjakut meqë rast pacienti edhe ka shpëtuar. Sa i përket rastit konkret nuk me kujtohet sakte se sa ka pas largësi ne mes te këtyre enëve dhe enëve kryesore por këto enë variojne ne çështje milimetrike dhe me se shumti deri 2 cm, pra largësia nga plaga ku e ka marr i dëmtuari ne raport me venet qe janë vdekjeprurëse ka hapësire vetëm milimetrike e me se shumti deri ne 2cm. Lidhur me formën e plagës se a është në formë të shkronjës T apo A, Doktor i lartcekur ka sqaruar: : E njëjta korrelojon me te dy shkronjat, por përfundimisht edhe nje here ritheksoj se kjo ka mundur te shkaktohet edhe nga nje goditje edhe nga dy goditje. Vetëm dua te ju sqaroj se ne raportin me shkrim qe ne përpilojmë pas intervenimeve ne vetëm konstatojmë se ka qene plage, por pa dhëne detaje te cilat ju shërbejnë juve se sa plage a po sa goditje ka mundur te jene aty, për shkak se siç specifikova me herët për neve e rëndësishme është qe te shpëtohet jeta e pacientit dhe jo detajet e tjera qe kane te bëjnë me plagë.

Pas dëgjimit të dëshmitarëve dhe faktit se nuk kishte pasur propozime tjera gjykata kishte proceduar me leximin e provave materiale. Gjykata nuk kishte proceduar tutje të dëgjoj edhe Doktorin tjetër i cili ka përpiluar raportin bashkë me Dr.Artan Haxhiun, pasi që edhe për përfaqësuesin e palës së dëmtuar i cili kishte dhënë këtë propozim, por edhe për gjykatën prania

e vetëm Dr.Artan Haxhiu ishte e mjaftuar për këto sqarime e po ashtu edhe përfaqësuesi i palë së dëmtuar kishte hequr dore nga propozimi, andaj edhe gjykata kishte proceduar me provat materiale.

Procedimi i provave materiale

Gjykata kishte vazhduar me rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor ku është vazhduar me leximin-administrimin e provave materiale, deklarimin e të akuzuarve si dhe me fjalën përfundimtare.

Gjykata në këtë seancë ka vazhduar me administrimin e provave materiale, ku si prova materiale ka administruar:

- 1.Lista e dëshmimeve e datës 08.02.2021;
- 2.Raporti i këqyrjes se vendit ngjarjes i dt. 07.02.2021;
- 3.Fotoalbumi i vendit te ngjarjes;
- 4.Ekspertiza mjeko-ligjore për lëndimet e te dëmtuarit F. Xh. e dt. 13.03.2021;
- 5.Flete lëshimi i dt. 08.02.2021;
- 6.Vërtetimi mbi sekuestrimin mbi marrjen e përkohshme te gjësendeve;
- 7.Fotoalbumet nga vendi i ngjarjes;
- 8.Flete lëshimi i dt.08.02.2021 qe korrespondon me hospitalizimin e te dëmtuarit me dt. 08.08.2021, nr. i historisë 71/32.

Meqë palët nuk kishin propozime tjera për plotësimin e provave materiale, gjykata tutje kishte proceduar me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor, me deklarimin e të akuzuarit Arsim Ajvazi.

Deklarimi i të akuzuarit

Gjykata kishte proceduar tutje me deklarimin e të akuzuarve, respektivisht për të dëgjuar mbrojtjen e tyre, por të tre të akuzuarit, pra të akuzuarit H. Sh., A. B. dhe A. B. kishin vendosur që të shfrytëzojnë të drejtën e tyre që të mbrohen në heshtje dhe se nuk ishin deklaruar para gjykatës.

Gjykata kishte nxjerrë edhe evidencën e të kaluarës kriminale, vetëm sa i përket aktgjykimeve që kanë marrë formën e prerë për të tre të akuzuarit dhe kishte rezultuar se: i akuzuari H. Sh. kishte dy aktgjykime të formës së prerë: 1.PM-65/2012 nga Gjykata Themelore ne Prishtine për veprën penale nga neni 162 Privimi i kundërligjshëm nga liria me masën edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit.

2.P nr.231/2021 nga Gjykata Themelore Prishtine dega ne D., vepra neni 349 Vjedhje Pylli, dënim me gjobe me shume 3500 Euro dhe dënim me kusht prej 6 muaj burg me afat verifikimi prej 2 vitesh.

I akuzuari A. B. kishte dy aktgjykime të formës së prerë: 1. PM-431/2019 Gjykata Themelore Prishtine vepra penale neni 185 Lëndim i lehte trupor – i është shqiptuar mase edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e organit te kujdestarisë ne kohëzgjatje prej 1 viti, te përmbahet nga takimi ose kontakti me njerëz te caktuar, te mos frekuentoje vende apo lokalitete te caktuara.

2. PM-192/2020 Vepra neni 184-Sulm- Masa mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, te përmbahet nga takimi ose kontakti me njerëz te caktuar, te mos frekuentoje vende apo lokalitete te caktuara. I akuzuari A. B. kishte dy aktgjykime të formës së prerë: 1. PM-172/2013 Gjykata Themelore Prishtine vepra keqpërdorim seksual i personave nen moshën 16 vjeç, dënim me kusht 1 vit burg me afat verifikimi prej 1 vit.

2. P nr. 205/2021 Gjykata Themelore Prishtine vepra nga neni 184 Sulm, dënim me kusht 6 muaj burg ne afat verifikimi prej 1 vit.

Meqë palët nuk kishin pasur propozime për plotësim të provave, gjykata kishte kaluar në fjalën përfundimtare të palëve.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën e saj përfundimtare ishte deklaruar si vijon: fjalën përfundimtare e kam përgatitur me shkrim ku te njëjtën e deponoj pranë Trupi Gjykues e po ashtu ne prani të të gjitha palëve te njëjtën do ta elaboroj ne detaje. Në mes tjerash prokurorja e shtetit ka specifikuar se nga të gjitha provat e prezantuara dhe administruara në shqyrtimin gjyqësor, deklaratimin e të dëmtuarit – dëshmitarit F. Xh., dëgjimin e dëshmitarit E. Gj. e po ashtu edhe deklarimet e Dr.Naim Uka dhe Dr.Artan Haxhiu janë vërtetuar faktet se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen. Tutje prokurorja e shtetit ka specifikuar se një kosntatim i tillë mbështetet edhe në provat materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor. Krejt në fund i ka propozuar gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar Avokat Gazmend Halilaj në fjalën e tij përfundimtare ishte deklaruar si vijon: E përkrahim fjalën përfundimtare te prokurorit te shtetit, duke konsideruar se ne rastin konkret prokurori i shtetit përmes mekanizmave ligjor ka arritur ne mënyre të plote qe gjykatës ti pasqyroje gjendjen faktike, po ashtu gjatë këtij gjykimi qofte ne procedurën qe ishte udhëhequr nga ish KTGJK, e po ashtu edhe nga KTGJK i tanishëm konsideroj se te njëjtit ne mënyre te plote kane respektuar te drejtat e palëve ne procedure për një gjykim te drejte e po ashtu duke respektuar edhe nenin 7 te KPPRKS-se, nuk ka asnjë dyshim se ne datën si dhe te dhënave te tjera si ne aktakuze te dy te pandehurit e pare me qellim dhe dashje te plote te pajisur me mjete te përshtatshme për te shkaktuar lëndim te rende trupor apo vdekje derisa i dëmtuari ishte krejtësisht pasiv, duar thate, te njëjtit e kane sulmuar me thika ne pjesën me vitale te trupit duke i shkaktuar lëndime te përjetshme e me rrezik tejet te madh për te privuar nga jeta ne momentin e shkaktimit te lëndimeve, kjo dëshkohet me provat e siguruara gjate fazës se hetimeve dhe tani ne shqyrtim kryesor kur prokurorja e nderuar ne mënyrë te detajuar e pasqyroj gjendjen ne fjale, po ashtu sa i përket dëshmisë se dëshmitarit E. Gj. dhe mjekut Artan Haxhiu, kjo e përforcon edhe metej akuzën e prokurorit te shtetit ndërsa dy dëshmitaret e dëgjuar te cilët ishin propozuar nga mbrojtësi i te pandehurit, gjegjësit nga avokati Hasan Jashari, konsideroj qe atyre dëshmime ne asnjë forme e as për se afërmi te mos ju falet besimi, këso dore duke besuar qe gjykatës i janë hequr dilemat edhe ne lidhje me çështjet kontestuese lidhur me numrin e plagëve me bindje te plote besoj qe te pandehurit duhet te shpallen fajtor për veprat penale për te cilat akuzohen, ndërsa me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal, gjykata sipas detyrës zyrtare po edhe ne baze te propozimeve tona duhet te aplikoj dispozitat gjegjësit nenin 38 te KPRK-se për faktin se edhe tani pas me shume se dy viete edhe pse duke qene ne dijeni qe me veprimet e tyre, te pandehurit ose e kane rrezikuar jetën palës se dëmtuar, këtë te fundit e kane lenë me pasoja te përjetshme qofte ne aspektin e shëndetit fizik e po ashtu edhe te shëndetit trupor sepse plagët janë ne pjese te dukshme te regjionit te fytyrës dhe kjo pa mëdyshje po e shkaktonte edhe dëme tjera si ne aspektin e punësimit edhe po ashtu edhe te martesës, ndërsa te pandehurit ne asnjë forme nuk kane ndërmarre asnjë veprim minimal për te shprehur keqardhje apo kompensuar apo çfarë do forme tjetër për te riparuar demin qe e kane shkaktuar vete. Sa i përket kërkesës pasurore juridike ne i paraqesim mirëpo ne kuadër te kompetencës lëndore kemi proceduar padinë ne kontest juridiko –civil.

I dëmtuari F. Xh. në fjalën e tij përfundimtare ishte deklaruar si vijon deklaron: E mbështes ne teri fjalën përfundimtare te prokurorit te shtetit dhe te përfaqësuesit tim.

Mbrojtësi i të akuzuarit H. Sh., Avokat Hasan Jashari në fjalën e tij përfundimtare ishte deklaruar si vijon: Se pari shprehi keqardhje për rastin që i ka ndodhur të dëmtuarit, por në jemi pale para TGJK-se dhe secila pale e ka detyrën e vet dhe jemi të obliguar që këtij TGJK t'i ofrojmë prova për të vërtetuar gjendjen e plote faktike në këtë çështje penale për të mundur të vihet në një vendim të drejtë. Konsideroj se më provat që janë shqyrtuar para këtij TGJK, më asnjë prove të vetme nuk është vërtetuar fajësia e të mbrojturit tim. Se pari si mbrojtës do të ndalem të motivi, qëllimi se i mbrojturi im a ka pasur motiv që ta kryejë këtë veprë penale apo nuk ka pasur asnjë lloj motivi. Në kohën kur ka ndodhur rasti, në muajin shkurt të vitit 2021, ka qenë kohe e fushatës që janë mbajtur zgjedhjet nacionale dhe në komunën e // kemi pasur dy subjekte politike që kanë qenë rival me njëra tjetrën dhe atë //, kur dihet se // ka fituar zgjedhjet vetëm në një komunë, në //, ndërsa ka qenë një gjendje shumë e acaruar në // mes këtyre subjekteve për të fituar zgjedhjet. I mbrojturi im ka qenë në subjektin politik të //, ku e ka pas edhe vëllain // të degës në // dhe i ka premtuar udhëheqësi në nivel qendror që nëse subjekti politik // fiton në //, i mbrojturi im do të punësohet dhe qëllimi tij ka qenë që të angazhohet non stop që ky subjekt politik të këtë votues sa më shumë dhe qëllimi tij ka qenë thjesht se çdo ditë të angazhohet në atë fushatë dhe është interesuar që të jete i pajisur vetëm me telefon dhe normal të këtë mjete financiare sa për kafe, andaj qëllimi tij thjesht ka qenë që të angazhohet në mënyrë maksimale, që t'i rijoje sa më shumë vota atij subjekti politik. Në ditën kritike kur ka dal në D., sikur çdo ditë tjetër më pare ka pasur vetëm telefonin më vete dhe mjete financiare në xhep, zakonisht takimet i kanë mbajtur në lokale në fillim, ndërsa më vonë ka dal në terren. Ditën kritike më palën e dëmtuar është takuar rastësisht nuk ka pasur asnjë paramendim se do të takohet më të dhe nga mendjelehtësia kur është takuar më të, i ka thënë "pse ma ke nguc nipin" e ka goditur më një shuplake dhe kundër shpërblim nga ai ka marrur një boks-grusht, që e ka tronditur aq fortë dhe në atë vend i ka rënë nga xhepi telefoni që e ka pasur në xhep. E në atë moment është gërrbav që ta marr telefonin ku këtë e kanë vërtetuar edhe dy dëshmitarët okular që kanë qenë në vend të ngjarjes, Sh. S. që në seancën e mbajtur më dt.08.02.2023 para këtij TGJK është deklaruar se në momentin kur H. Sh. e ka marrë telefonin nga toka ku i kishte rënë më pare, e ka vërejt të dëmtuarin F. Xh. i cili ka pas gjak në qafe, ndërsa H. ka qenë diku 4-5 metra larg tij dhe se nuk e ka ndërmarre asnjë veprim inkriminues në këtë rast, të njëjtën deklaratë e jep edhe dëshmitari tjetër okular, A. S., në seancën e mbajtur më dt. 23.02.2023. Gjendjen e plote faktike në këtë çështje penale-juridike e vërtetojnë këta dëshmitarë dhe prova të tjera që ndryshon nga ajo gjendje e plote faktike që e ka paraqit prokurori i shtetit. Ekspertiza mjeko-ligjore e dt. 16.03.2021 që e a dhënë grupi i mjekëve kompetent profesional në faqen e pare të kësaj ekspertizë në rreshtin e 7 thuhet "Nga lëndimi më thike, nga përleshja pike." Pra këtu i referohet numrit njëjës, pra është përdorur një thike dhe jo disa thika. Gjendjen e plote faktike për ndryshim nga ajo se çka ka paraqitur prokurori i shtetit e vërteton edhe eksperti mjeko-ligjor dr.Naim Uka që në seancën e dt 08.02.2023 në pyetje të shumta që janë bërë nga palët në procedurë dhe nga vet TGJK e ka dhënë mendimin dhe konstatimin se të i dëmtuari ekziston vetëm një plagë , një mjet i fortë mekanik prehtes dhe jo dy plaga, këtë e vërteton edhe dëshmitari dr. Artan Haxhiu të dhënë në seancën e sotme, i cili në pyetjet e palëve dhe të TGJK u deklarua se nuk mundem më të dallu se a ka qenë një apo dy goditje.

Konsideroj se për TGJK nuk ka prove më të besueshme sesa ekspertiza mjeko-ligjore dhe sesa ekspert mjeko-ligjor që në këtë seancë e kanë dhënë dëshminë e vet. Prandaj këtij TGJK i propozoj se në rastin e marrjes së vendimit të ia fal besimin këtyre provave të lartcekura dhe në fund të marr një vendim të drejtë dhe për neve si mbrojtjes vendimi i drejtë është vetëm aktgjykimi lirues në mungesë të provave. Jemi të bindur se ky TGJK qysh ka pasur durim të na dëgjojë në disa seanca më paraqitjen e provave nga pala në procedurë do të këtë durim edhe të na lexojë edhe të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe do të marr një vendim siç e ceka më lartë. Kur kërkohet aktgjykim lirues kjo nënkupton edhe ndërprerjen e masës së

paraburgimit ku dihet se i mbrojturi im është ne paraburgim qe rreth dy viteve e katër muaj, por jo me fajin e këtij TGJK.

I akuzuari H. Sh. në fjalën e tij përfundimtare ishte deklaruar si vijon: E mbështes ne tërësi fjalën përfundimtare te avokatit tim dhe nuk kam se çka te deklaroj me shume.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. B. Avokat Ahmet Gjinovci në fjalën e tij përfundimtare ishte deklaruar si vijon: Ne fillim shprehi keqardhje te dëmtuarit F. dhe familjes se tij, për rastin qe ka ndodh, rast i cili është për keqardhje edhe për mjedisin ku jeton dhe banon dhe për shoqërinë ne tërësi. Konsideroj se me provat e administruara qofte formale apo materiale gjate shqyrtimeve gjyqësore nuk është vërtetuar përtej dyshimit te bazuar mire teza e aktakuzës, respektivisht pretendimet e prokurorisë ne te cilat pretendon se i mbrojturi im A. B. ka kryer veprat penale te cilat i vihen ne barre sipas aktakuzës i cili është objekt gjykimi. Ne shqyrtimet gjyqësore kemi dëgjuar dëshmitaret si dhe vet te dëmtuarin F. i cili ne hetuesi edhe këtu ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me te akuzuarin A. kurrë nuk ka pasur ndonjë mosmarrëveshje ne te kaluar por as ne ditën kritike, kjo deklarate e tij përputhet ne tërësi edhe me deklaratën e te mbrojturit tim A. i cili si ne hetuesi ashtu edhe ne shqyrtimin gjyqësor para këtij TGJK ka deklaruar se me te dëmtuarin F. asnjëherë nuk ka pas ndonjë mosmarrëveshje qofte ne te kaluarën apo ne ditën kritike. Kjo tregon respektivisht provon faktin e pakontestueshëm se ne rastin konkret i mbrojturi im A. nuk ka pasur kurrfarë motivi as qëllimi apo dashje qe te dëmtuarit F. t'i shkaktoj lëndime siç pretendon prokuroria ne aktakuze. Nga mendimi i ekspertizës mjeko-ligjore vërtetohet se ne rastin konkret te i dëmtuari F. kemi vetëm një lëndim. Ne seancën e kaluar por edhe ne shqyrtimin e sotëm, dëshmitari- mjeku i cili u dëgjua nuk e vërtetoi ndryshe gjendjen faktike, por vetëm ajo qe ishte ne ekspertize e qe do te thotë se është vetëm një lëndim. Te kjo gjendje faktike po e përsëris edhe njëherë se te i mbrojturi im A. nuk ka pasur kurrfarë motivi, e motivi konsideroj se është i lidhur edhe me dashjen e kryerjes se veprës penale apo edhe ndërmarrjen e veprimeve ne drejtim te kryerjes se veprës penale. Mendoj qe ne këtë rast konkret është krijuar një mjegullim sepse siç theksova edhe me herët nuk janë kryer hetimet ne mënyre te drejte dhe te plote. Ketë po e them për faktin se nga deklaratat e dëshmitareve qe gjinden ne shkresat e lendes janë përmendur se prezent kane qene diku rreth me tepër se 10 police dhe asnjë nga ata nuk është propozuar si dëshmitarë sepse nuk dihen as emrat e tyre. Mendoj se sikur te ishin dëgjuar këta dëshmitarë do te ndriçonim gjendjen faktike lidhur me ngjarjen e qe do te ishte një lehtësim edhe për te gjithë. Andaj pasi qe nuk është vërtetuar se i mbrojturi im ka kryer veprat penale për te cilat ngarkohet i propozoj gjykatës qe te merr aktgjykim lirues ne mungese te provave. Ne fund propozoj qe ndaj te mbrojturit tim ti ndërpritet masa e paraburgimit sepse konsideroj se kane pushuar te gjitha arsyet ligjore mbi bazën e te cilave i njëjti gjendet ne paraburgim.

I akuzuari A. B. në fjalën e tij përfundimtare ishte deklaruar si vijon: E përkrahi ne tërësi fjalën e avokatit tim dhe nuk kam tjetër se çfarë te shtoj.

I akuzuari A. B. në fjalën e tij përfundimtare ishte deklaruar si vijon: Ne këtë shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar qe unë kam kryer ndonjë vepër penale, unë ndihem plotësisht i pafajshëm, sepse unë vetëm i kam ndare.

VLERËSIMI I PROVAVE

Gjykata në vazhdim do të analizoj secilën provë si vijon:

Provat personale dhe materiale

- 1.Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit – F. Xh.
- 2.Dëshmia e dëshmitarit – E. Gj.
- 3.Deklarimi dhe sqarimet e ekspertit– Dr.Naim Uka
- 4.Dëshmia e dëshmitarit – Sh. S.
- 5.Dëshmia e dëshmitarit – E. S.
- 6.Deklarimi dhe sqarimet e ekspertit– Artan Haxhiu
- 7.Lista e dëshmimeve e datës 08.02.2021;
- 8.Raporti i këqyrjes se vendit ngjarjes i dt. 07.02.2021;
- 9.Fotoalbumi i vendit te ngjarjes;
- 10.Ekspertiza mjeko-ligjore për lëndimet e te dëmtuarit F. Xh. e dt. 13.03.2021;
- 11.Flete lëshimi i dt. 08.02.2021;
- 12.Vërtetimi mbi sekuestrimin mbi marrjen e përkohshme te gjëseneve;
- 13.Fotoalbumet nga vendi i ngjarjes;
- 14.Flete lëshimi i dt.08.02.2021 qe korrespondon me hospitalizimin e te dëmtuarit me dt. 08.08.2021, nr. i historisë 71/32.

Gjykata në vazhdim do të trajtoj se cilën provë veç e veç dhe do nxjerr përfundimet për çështjet dhe faktet që i ka vërtetuar për gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Me qëllim të krijimit të një pasqyre të plotë lidhur me rastin, gjykata gjatë analizimit të deklaratave, si dhe administrimit të të gjitha provave tjera do të koncentrohet në fragmentet të cilat ndriçojnë objektin e çështjes.

Faktet jo kontestuese

Për të mos krijuar huti, përgjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, kjo gjykatë fillimisht konstaton se për gjykatën nuk ishte kontestueses fakti se me datë //././.2021, rreth orës // min, në rrugën “//” në D., ka ndodhur një perleshje në mes të disa personave që nuk janë identifikuar të gjithë, por të përfshirë ishin edhe tani të akuzuarit H. Sh., A. B., A. B., e po ashtu edhe i dëmtuari F. Xh. dhe dëshmitari E. Gj..

Fakti se te njejtit kanë qenë të përfshirë në këtë perleshje nuk e mohojn asnjëri nga të lartcekurit veç se nuk pranojnë veprimet konkrete.

Për gjykatën nuk është kontestues as fakti se në këtë perleshje ka mbetur i dëmtuar rëndë tani i dëmtuari F. Xh., madje nuk është kontestues as fakti se plaga e tij ka mundur te jete vdekjeprurëse, respektivisht ka pësuar lëndime të rënda trupore, plagë prerëse në regjionin e qafës, enfizem e lehtë subkutane, prishje e kontunitetit të indeve të buta, submandibullare të qafës dhe skajit të poshtëm të gjandres pshtymore submandibullare të majtë, lëndime këto të shkaktuara si rezultat i veprimit mekanik të mejtit të fortë dhe të mprehtë.

Për gjykatën, kontestuese kishin mbetur zbardhja e fakteve se kush ia kishte shkaktuar këto plagë tani të dëmtuarit, respektivisht se a ishte i akuzuari H. apo A. ata qe i kishin shkaktuar keto demtime te akuzuarit, fakti po qe se te njejtit kishin armë të ftofta me vete dhe veprimet e secilit të akuzuar veç e veç. Tutje gjykata kishte për të zbardhur edhe faktin po që se i akuzuari A.kishte marr pjesë në rrahje.

Para se kjo gjykatë ti trajtoj faktet kontestuese dhe elaborimin e te gjitha provave një nga një, të gjithave sbashhku dhe nxjerjen e perfundimeve, kjo gjykatë specifikon faktin se për gjatë seancave gjyqësore janë përmendur edhe persona tjerë të përfshirë në këtë rast, por të njejtit nuk janë arritur të identifikohen as nga i dëmtuari, as nga dëshmitarët as nga vet të akuzuarit dhe të njejtit nuk janë objekt i akuzës, andaj gjykata do të lëshohet vetëm në vërtetimin e fakteve që

kanë të bëjnë me objektin e akuzuës, andaj vazhdimi i arsyetimit të këtij aktgjykimi dhe nxjeraja e përfunimeve i përket vetëm objektit të akuzës, repektivisht trajtimit të fakteve kontesutese të elaboruar më sipër.

Faktet kontestutese

Në vazhden e e arsyetimit të këtij aktgjykimi, kjo gjykatë të njejtin do ta ndaj në disa etapa duke trajtuar veprat penale veç e veç dhe me cilat provat cilat fakte i ka vërtetuar ose jo.

Trajtimi i vepres penale nga dispozitivi I, vepra penale Vrasje në tentativë në bashkë kryerje.

Lidhur me faktet kontesutese duke ju referuar fillimisht vepres penale të vrases në tentativë, kjo gjykatë në vijm do të jap arsye se si e ka trajtuar gjykata çdo provë veç e veç, cilës provë ja ka falur besimin dhe cilës jo dhe arsyet mbi këto shkaqe, e po ashtu do të nxjeren përfundimet në lidhsmëri të të gjitha provave sëbashku.

Gjykata në tërësi i'a fali besimin deklaratës së të dëmtuarit – dëshmitarit, F. Xh., nga i cili fillimisht zbardhen faktet jo-kontestuese, nga deklarata e te cilit fillimisht është konstatuar se me datë //././2021, rreth orës // min, në rrugën “//” në D., pas një mosmarrveshje paraprake në mes të akuzuarve H. Sh. dhe A. B. në njërën anë dhe të dëmtuarit F. Xh. në anën tjetër ka pasur perleshje fizike. Tutje nga kjo deklaratë po ashtu vërtetohet fakti jo-kontesutes se i dëmtuari ka marr goditje me thikë në qafë. Kjo gjykatë në kuptim të hallkës zingjimore në kuptim të të provuarit se a kush e ka goditur me thikë tani të dëmtuarin, nga deklarata e vet personit të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit F. Xh. ka arritur të vërtetoj faktin se fillimisht ka paur nje fjalosje me te akuzuarit H. dhe A. ku rjedha e ngjarjes dhe kronologjia e saj ka filluar ne lokalin “//” në D. ku i dëmtuari ka qenë me shokun e tij me E. Gj.. Fakti që qon se protagonist të perleshjes mes tyre ka qenë fillimisht i akuzuari H. veretohet po nga deklarata e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit, per faktin se në kafenenë e lartcekur ka qenë i akuzuari H. që ka filluar të njëjtit siç thotë dëshmitari ta shikoj “mrolt” ndërsa tutje kur ka dalur nga kafeneja kanëfilluar ta percjellin dhe tutje ka vërejtur se nga një anë e ka përcjellur i akuzuari H. me disa persona ndërsa pastaj në rrugë i ka dalë i akuzuari A. me disa persona e të cilët e kan ndalur. Përleshja ka filluar kur i akuzuari H. i ka thënë të dëmtuarit “pse ma ke nguc nipin” dhe e ka gogirut me shuplak në fytyrë. Tek pika inkriminuese dhe kontesutese, gjykata ia ka falur besimin të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit, se edhe i akuzuari H. edhe A. kanë pasur thika me vete dhe se ka qenë i akuzuari A. i cili e ka goditur i pari me thikë në qafë ku edhe e ka “ngreh thikën” dhe per gjatë përleshjes pas pak sekondave e ka goditur edhe i akuzuari H. po ashtu me thikë për rreth qafës afërsisht në vendin e njejtë. Deklarata e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit është e besueshme fillimisht për faktin se gjitha deklaratat e tij për gjatë gjitha marrjeve në pyetje kanë qenë thuajse identike, por edhe për faktin se kjo deklarat e tijë gjenë mbështetje edhe në provat e tjera të administruara. Rjedha e ngjarjes dhe momentet kritike, repsketivisht goditjet me thikë që i ka artikulluar i dëmtuari, janë në përputhje të plotë edhe me deklaratën e dëshmitarit E. Gj.t i cili ka qenë dëshmitar okular dhe ka tentuar që ta shpëtoj F.in dhe ka vërejtur çdo veprim të secilit të akuzuar. Fakti se deklarata e dëshmitarit F. Xh. është e mbështetur në provat tjera të administruara vërtetohet edhe nga fakti se edhe prova materiale repektivisht, Ekspertiza mjekoligjore për lëndimet e te dëmtuarit F. Xh. e dt. 13.03.2021, Flete lëshimi i dt. 08.02.2021, Flete lëshimi i dt.08.02.2021 qe korrespondon me hospitalizimin e te dëmtuarit me dt. 08.08.2021, nr. i historisë 71/32, e bëjnë pikrisht të besueshm deklarata e F. Xh., sepse nga provat materiale te lartcekura është konstatuar fakti se i dëmtuari është gotirur me mjet të mpreht të fortë në regjionin

e qafës e që është në përputhje të plotë me vet deklartën e të dëmtuarit i cili specifikon se është goditur me thikë nga të akuzuarit.

Deklarata e F., është në përputhje të plotë edhe me raportin e kqyrjes se vendit të ngjarjes ku specifikohet saktë vendi ku ka ndodhur perleshja, por edhe njollat e gjakut që janë gjetur në vendin e ngjarjes, ndërsa sa i perket plagëve që u elaboruan më sipër e që janë specifikuar edhe në deklaratën e vet F., por edhe në raportet mjekësore, janë në përputhje edhe me fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës ku shihen qartazi fotografitë e plagës së tani të dëmtuarit.

Marr për bazë faktin se deklarata e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit gjenë përputhje të plotë edhe në provat e lartshenuara, gjykata kësaj deklarate ia fali në tërësi besimin.

Nga kjo deklarata gjykata ka arritur të vërteton faktin se personat që e kanë goditur me thikë të dëmtuarin, kanë qenë të akuzuarit H. Sh. dhe A. B., ku i pari e ka goditur me thikë i akuzuari A. në regjionin e qafës dhe menjëherë pas tij (pas disa sekondave) edhe i akuzuari H. Sh. po ashtu me thikë në të njëjtin vend e ka goditur në regjionin e qafës.

Kjo gjykatë ka analizuar me kujdes edhe dëshminë e dëshmitarit E. Gj., i cili për gjykatën ka rikonstatuar faktet jo-kontestuese e të cilat janë specifikuar edhe më sipër.

Dëshmitari E. Gj., për këtë gjykatë ka luajtur një rol crucial për vërtetimin e gjendjes faktike, pasi që përveç të dëmtuarit, është dëshmitari i vetëm okular në këtë çështje i cili e ka parë gjithë rrjedhën e ngjarjes, është munduar ta shpëtoj të dëmtuarin nga goditjet e personave që kanë qenë në perleshje e po ashtu ka arritur ti shoh të gjitha veprimet e inkriminuese të të gjithë të akuzuarve, respektivisht edhe momentet kritike kur i dëmtuari është goditur me thikë.

Dëshmitari E. ka rëfyer rjedhën-kronologjinë e ngjarjes në mynyrë identike si i dëmtuari prej momentit ku bashkarisht kanë qenë duke pirë kafe, takimin e parë me H. Sh., përcjelljen nga grupi i H. dhe A. e deri kur kanë arritur tek vendi ku ka ndodhur perleshja, tregime këto të elaboruara më sipër.

Sa i përket momentit kritik dëshmitari rrefen se fillimisht i akuzuari H. u është drejtuar me fjalët se “pse ma keni nguc nipin” dhe e ka goditur me shuplakë të dëmtuarin F., ku F. ia ka kthyer për tu vetëmbrojtur ndërsa i akuzuari H. e ka nxjerrë thikën, siç ka shpjeguar dëshmitari të zezë të madhe, thikë të cilën e ka emruar si “thikë patent” dhe ka qenë dëshmitari E. që rrefen se në ato momente e ka kapur të akuzuarin H. që mos ta lejoj ta godet F. in dhe në ato momente e ka parë të akuzuarin A. që ka shkuar në drejtim të F. dhe e ka goditur me thikë në qafë e po ashtu i akuzuari H. i ka thënë lëshom se të godas edhe ty dhe në ato momente e ka lëshuar dhe se ka qenë edhe i akuzuari H. që ka shkuar në drejtim të F. dhe se me thikë e ka goditur po ashtu në qafë.

Fakti se kanë qenë të akuzuarit H. dhe A. ata që e kanë goditur që të dy F. Xh. me thikë është shpjeguar në detaje për gjatë shqyrtimit gjyqësor nga dëshmitari E.. Siç është theksuar edhe më sipër dëshmitari E. Gj. përveç të dëmtuarit, ka qenë i vetmi dëshmitar okular që është identifikuar dhe që e ka arritur të identifikoj veprimet e secilit pjesëmarrës në këtë rrahje.

Gjykata ia fali në tërësi besimin deklaratimit të dëshmitarit E. Gj. pasi që ishte në përputhje të plotë edhe me deklaratën e të dëmtuarit-dëshmitarit F. Xh. i cili po ashtu në mënyre identike ka shpjeguar veprimet e të akuzuarve H. dhe A. dhe menyra se ku dhe si e kanë goditur të njëjtit me thikë. Siç është specifikuar më sipër për deklartën e të dëmtuarit-dëshmitarit F. Xh. se ishte në përputhje të plotë edhe me provat materiale të administruara edhe deklarata e dëshmitarit gjene përputhje të plote me raportet mjekësore të administruarat dhe fotografitë e vendit të ngjarjes ku shihet plaga e të dëmtuarit F. që është pikërisht në qafë siç e ka elaboruar dëshmitari E. e po ashtu në raportet mjekësore, respektivisht ekspertizat mjeko ligjore ku është konstatuar se i dëmtuari F. Xh. është goditur me mjet të fortë mprehtë në regjionin e qafës.

Një fakt determinuese mbi arsyen e të cilës, gjetjen fajtor të të akuzuarve gjykata e mbështet pikërisht në dëshminë e këtij dëshmitari, është fakti se dëshmitari E. Gj. ka qenë dëshmitari i parë i cili është dëgjuar në polici ditën kritike, pra menjëherë pasi që kishte ndodhur rasti dhe

pikërisht nga deklaratat e tij ka filluar edhe të ndërtohet rasti. Në momentin kur dëshmitari E. ka deklaruar në polici, të akuzuarit kanë qenë në arrati, ndërsa i dëmtuari duke luftuar me jetë, andaj dëshmitari E. ka rrëfyer vetëm atë që e ka parë dhe nuk ka mundur të koordinohet me as kënd, nuk ka mundur të ndikohet nga askush, andaj edhe deklaratimet e tij gjykata i ka pranuar si të vërteta. Dëshmitari i lartshënuar në dëshminë e parë që e ka dhënë në polici, pikërisht ditën kritike, menjëherë pasi që kishte ndodhur rasti, ka specifikuar edhe në atë deklaratë në mënyrë identike si në shqyrtimin gjyqësor, rrjedhën dhe kronologjinë e ngjarjes dhe faktin se edhe i akuzuari A. edhe i akuzuari H. e kanë goditur në qafë të dëmtuarin me thika siç i ka quajtur ai që hapen me pullë “patent”.

Nga arsyet bindës të elaboruar ma sipër, gjykata i ka falur në tërësi besimin deklaramit të dëshmitarit E. Gj. dhe për gjykatën dëshmia e tij ka pasur peshë të veçantë pikërisht për kohën kur i njejt i është intervistuar. Mbështetur në deklaratën e tij, gjykata ka vërtetuar faktin se edhe i akuzuari A. edhe i akuzuari H. e kanë goditur të dëmtuarin me thika në qafë.

Në vazhdim të aktgjykimit gjykata do ti trajtoj dëshmitë e dëshmitarëve Sh. S. dhe E. S., ndërsa pas tyre do ti trajtoj deklaratimet e eksperteve Dr.Naim Uka dhe Dr.Artan Haxhiu, kjo për faktin se dëshmitë e dëshmitarit Sh. dhe E. kanë lidhsmëri mes vete dhe në anën tjetër do të trajtohen në mënyrë të veçantë edhe deklaratimet e Dr.Naim Uka dhe Dr.Artan Haxhiu lidhur me çështjet kontestues në raport me plagën e të dëmtuarit.

Dëshmitarët Sh. S. dhe E. S. janë propozuar nga mbrojtja e të akuzuarit H. Sh. për tu argumentuar fakti se i akuzuari H. nuk ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Dëshmitari Sh. dhe E. S. kanë qenë rastësisht duke kaluar kah vendi ngjarjes dhe deklaratat e tyre janë thujse identike, andaj edhe do të trajtohen në të njëjtën formë. Siç kanë shpjeguar të njëjtit para gjykatës, ka qenë një grumbull i madh i personave duke u përleshur mes vete. Dëshmitari Sh. ka specifikuar se i ka njohur dhe i ka identifikuar se aty kanë qenë H., A. e F., po ashtu ka theksuar se në momentin kur e ka parë H. i njejt i ka qenë 2-3 metra largë të dëmtuarit F. dhe ka parë po ashtu se të akuzuarit H. i ka rënë një telefon i zi në tokë. Mbi këto deklarime mbrojtja ka pretenduar të specifikoj se H. nuk e ka goditur me thikë të dëmtuarin F. dhe se ka pasur vetëm një telefon që i ka rënë në tokë duke aluduar se nuk ka pasur thikë dhe ka qenë në distancë me F..

Gjykata tutje duke sqarur më shumë situatën dhe duke i parashtruar pyetje dëshmitarit Sh., dëshmitari po ashtu ka ri konstatuar faktin se ka parë të dëmtuarin F. të gjakosur në qafë, por ka specifikuar faktin se nuk ka arritur të shoh veprimet e asnjërit prej këtyre personave dhe se nuk e ka parë as momentin kur është goditur F. me thikë e as kush e ka goditur. Në këto rrethana nuk është sqaruar diçka e re nga dëshmitari Sh. për faktin se i njëjti vetëm ka specifikuar se ka kaluar andej kur ka ndodhur përleshja, por për shkak të grumbullit të madh të njerëzve nuk ka arritur të shoh më shumë sa i përket momentin kritik e që për gjykatën ishte thelbësore. Në këto rrethana kjo deklaratë nuk shkoi as në favorin e mbrojtës se të akuzuarit H., për faktin se dëshmitari ka pohuar se i dëmtuari ka pasur gjak në qafë, ndërsa në anën tjetër nuk ka arritur të shoh se po që se dikush tjetër e ka goditur të dëmtuarin e me ç ‘rast do të zhveshje nga përgjegjësia i akuzuari H..

Siç u theksua edhe më lartë edhe deklarata e dëshmitarit E. ka qenë thujse identike veç se ai ka deklamuar se e ka parë edhe të akuzuarin A. në turmë, por pa specifikuar veprimet e tija. Edhe dëshmitari E. ka theksuar se nuk i ka parë momentet kritike pasi që ka pasur shumë njerëz dhe se nuk i ka vërejtur momentet se kush kënd e ka goditur dhe se si i ka marrë plagët i dëmtuari F.. Të dy dëshmitarët kanë specifikuar se kanë ardhur disa njerëz që kanë bërëtur policia polica dhe turma është shpërnda.

Duke marr për bazë barazimin e armëve mes mbrojtës dhe prokurorisë së shtetit para gjykatës, gjykata kishte dëgjuar dy dëshmitarët e lartcekur, mirëpo të njëjti nuk kanë arritur të zbardhin

ndonjë gjendje tjetër faktike, për faktin se të njëjtit nuk kanë parë momentet kritike, respektivisht nuk kanë arritur të shohim momentin se kush dhe kur e ka goditur të dëmtuarin F. me thikë në qafë. Në këto rrethana deklaratat e këtyre dëshmitarëve nuk kanë pasur ndonjë peshë të veçantë lidhur me marrjen e aktgjykimit, pasi që të njëjtit nuk kanë zbardhur asgjë lidhur me gjendjen faktike objekt i këtij shqyrtimi. Sikurse dëshmitarët të kishin parë dikë duke goditur me thikë të dëmtuarit dhe se këta persona të mos ishin tani të akuzuarit H. e A., atëherë do kishim një baraspeshë të provave dhe pista e hetimit do të mund të drejtohej edhe në kahje të tjera, por në këto rrethana dëshmitarët Sh. dhe E. nuk kanë arritur fare ta shohin momentin kritik, andaj edhe deklaratat e tyre nuk kishin nodnjë relevancë të posaçme në kuptim të zbardhjes së gjendjes faktike, e as në faktin se të akuzuarit H. e A. nuk janë kryes të kësaj vepre penale.

Kjo gjykatë me kujdes ka analizuar deklaratën e ekspertit mjeko-ligjor Dr.Naim Uka i cili ka elaboruar ekspertizën për lëndimet trupore të cilat i ka pësuar tani i dëmtuari F. Xh..

Eksperti ka sqaruar vendin ku është goditur i dëmtuari dhe faktin se i njëjti është goditur me mjet të fortë të mprehtë.

Dilema për palët në procedurë, por edhe për gjykatën ishte në faktin se a është goditur një here apo dy here me thikë tani i dëmtuari.

Lidhur me këtë fakt tejet të rëndësishëm eksperti i lartcekur ka sqaruar: nuk përjashtohet si mundësi, pra mundet me qen dy goditje ne te njëjtin vend dhe te formojnë një plagë. Për te qene me i qarte dhe ju ti kuptoni procedurat qe ne i ndjekim dua t'ju sqaroj se gjatë procedurave mjekoligjore te autopsive te ndryshme si dhe konkretisht te autopsive ku ka lëndime - dëmtime te shkaktuara nga veprimi mekanik i majës dhe tehit te mjetit te forte, ne si mjek ligjore kemi përparësi e kohës për eksplorimin dhe ekzaminimin e detajuar te vendit te dëmtuar ku e bëjmë përshkrimin e sakte duke ber edhe matjet e gjatësisë, gjerësisë, dhe thellësisë se plagës- plagëve te cilat shoqërohen pastaj edhe me fotografi. Ndërsa ne klinikat e SHSUK-se atë Emergjente dhe te gjitha klinikat kirurgjike është çështje e faktorit kohe ne trajtimin e rasteve urgjente ku rrezikohet jeta e te dëmtuarit gjithmonë mbetet prioritet intervenimit mjekësor me qellim te shpëtimit te jetës, kurse si detyre sekondare mbetet përshkrimi i karakteristikave te dëmtimit. edhe intervenimi mjekësorë- drenazhe krijohet me veprimin e tehut te një skalperi qe është mekanizëm mprehtës i ngjashëm me atë te thikës, mirëpo me qëllime mjekësorë, prandaj si përfundim mund te konkludoj se edhe vrahja qe përpunohet me qellim te intervenimit kirurgjik shkaktohet me mekanizmin e njëjte, e qe rrjedhimisht ato nuk mund te dallohen njëra nga tjetra sepse janë identike.

Eksperti ka sqaruar edhe dallimet qe mund te jenë në mes të raporteve të kirurgëve dhe mjeko-ligjorëve duke specifikuar se: Për sqarimin e juaj ky dallim bazohet ne faktin, sepse kirurget kane për qellim qe me urgjence të shpëtojnë jetën, ndërsa ne si mjek ligjore qëllimi yni i vetëm është konstatimi, kualifikimi i dëmtimeve dhe pasojave ne shëndet. Pra sikurse te ishte ber një ekzaminim direkt do te kishte mundur te këtë dallime. Krejt në fund lidhur me faktin se plagët që ka marr i dëmtuari a kanë mundur të jenë vdekje-prurese, eksperti ka specifikuar se: plaga e konstatuar ne akt ekspertimin mjeko-ligjor ka te beje me një regjion te ndjeshëm për jetën e te dëmtuarit, mirëpo fatmirësisht ne atë regjion nuk janë atakuar enët dhe strukturat vitale jetësore. Këto struktura janë afër plagës dhe sikurse ato te prekeshin do te ishin fatale për jete.

Në këto rrethana nga sqarimet e ekspertit, gjykata ka arritur të konkludoj faktin se eksperti mjeko ligjor, ekspertizën e tij e ka mbështetur nga të dhënat e mjekëve emergjent që kanë kryer operimin me qëllim të shpëtimit të jetës së tani të dëmtuarit, ndërsa po ashtu gjykata nga ky deklaramund të konkludoj se ka dallime mes asaj se si i konstatojnë dëmtimet mjeko-ligjoret dhe kirurget që janë në front për të shpëtuar jetën, ndërsa raporti mjeko ligjor është nxjerrë vetëm nga këto të dhëna, sepse eksperti mjeko ligjor nuk e ka parë të dëmtuarin.

Tutje nga deklarata e të lartcekurit mund të konkludohet se plagët që ka marr i dëmtuari kanë qenë plagë që kanë mundur të përfundojnë me fatalitet dhe se kirurget kanë vepruar me urgjencë

gjë që edhe eksperti Dr.Naim Uka konstaton se aq e madhe ka qenë urgjenca sa që edhe raporti i kirurgëve ka edhe ndryshime për gjatë përpilimit.

Tutje lidhur me çështjen kryesore se a është goditur me thikë një here apo dy here i dëmtuari, Dr.Naim Uka ka konkluduar se nuk përjashtohet asnjëra mundësi, sepse edhe drenazha nga kirurgët bëhet me mjet të mprehtë me skallper për qëllime mjekësore edhe goditjet janë bërë me mjet të fortë dhe se plaga ka qenë e hapur, andaj edhe nuk mund të specifikohet me saktësi se sa goditje ka marrë i dëmtuari.

Nga këto konstatime të ekspertit, gjykata ka nxjerr përfundimin se për shkak të rrezikut të madh për jetën e të dëmtuarit, ka qenë në plan të dytë për kirurgët se sa here është goditur i dëmtuari, sepse qëllimi ka qenë shpëtimi i jetës së tij, andaj edhe nuk janë marrë me këtë çështje dhe se konkludimi që është nxjerrë nga kjo deklaratë rezulton se nuk përjashtohet asnjëra mundësi se sa goditje ka pësuar i dëmtuari.

Për aq kohë sa Dr.Naim Uka nuk ka dhënë ndonjë konstatim ndryshe nga dëshmitë e administruara deri tani, pra nga deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit F. Xh. dhe deklarata e dëshmitarit E. Gj. që është konkluduar-vërtetuar se të dy të akuzuarit e kanë goditur në qafë të dëmtuarin dhe përderisa Dr.Naim Uka nuk e përjashton një mundësi të tillë, gjykata nuk ka mëdyshje në konstatimin se i dëmtuari është goditur dy here (një here nga secili i akuzuar), andaj edhe konstaton faktin se i dëmtuari është goditur dy here në qafë me mjet të mprehtë (thikë), në të kundërtën po që se gjykata do të kishte mëdyshje në këtë fakt atëherë këto mëdyshje në kuptim të *parimit in dubio pro reo* do të argumentonte në favorin e të akuzuarve.

Me qëllim të sqarimit edhe më të detajuar sa i përket plagës – goditjeve që ka pësuar i dëmtuari dhe për mos të lënë pa-qartësinë as më të vogël përkritazi me këtë çështje, gjykata kishte aprovuar propozimin e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, që në gjykatë të ftohet edhe njëri nga kirurgët që ka bërë ekzaminimin e të dëmtuarit dhe raportin fillestar mbi plagën e tij, andaj edhe gjykata kishte dëgjuar Dr.Artan Haxhiu.

Lidhur me dilemat e ngritura Dr. Artan Haxhiu në seancë e shqyrtimit gjyqësor kishte sqaruar se: në rastin konkret është dashur të veprohet me urgjencë përshkak se plaga e tij ka qenë e madhe edhe e hapur dhe me gjakderdhje të madhe dhe se vendi ku i njejtë është goditur është në distancë milimetrike nga arteria kryesore e e cila do të shkaktonte vdekjen. Tutje duke shiquar plagën e të dëmtuarit e po ashtu edhe fotografitë dhe raportin, Dr.Artan Haxhiu ishte sqaruar: Lidhur me formën e plagës se a është në formë të shkronjës T apo A, Doktor i lartcekur ka sqaruar: : E njëjta korrelohet me të dy shkronjat, por përfundimisht edhe një here ritheksoj se kjo ka mundur të shkaktohet edhe nga një goditje edhe nga dy goditje. Vetëm dua të ju sqaroj se në raportin me shkrim që ne përpilojmë pas intervenimeve ne vetëm konstatojmë se ka qenë plage, por pa dhënë detaje të cilat ju shërbejnë juve se sa plage a po sa goditje ka mundur të jenë aty, për shkak se siç specifikova me herët për neve e rëndësishme është që të shpëtohet jeta e pacientit dhe jo detajet e tjera që kanë të bëjnë me plagë.

Nga elaborimet e Dr.Artan Haxhiu mund të konkludohet edhe njëherë fakti se në rastin konkret për shkak të urgjencës së rastit kirurgët nuk janë marrë fare me faktin se a kanë qenë një apo dy therje dhe se nuk përjashtohet asnjëra nga këto mundësi, madje eksperti sqaron se fakti se në raport i janë referuar me termin plagë nuk do të thotë se kanë aluduar se ka të bëjë vetëm me një goditje por të njëjtën vetëm e kanë trajtuar si plagë.

Edhe nga ky konstatim vihet në përfundimin se aq e rrezikshme ka qenë plaga dhe se aq shpejtë është dashur të ndërhyhet për të shpëtuar jetën e tani të dëmtuarit sa që çdo gjë tjetër ka qenë në planin e dytë.

Nga Dr.Artan Haxhiu vërtetohet fakti me rëndësi, se fakti të njëjtit në raport i janë referuar si plagë nuk është menduar në një goditje dhe se nuk mund të konkludohet me saktësi se a kanë qenë një apo dy goditje për shkak të urgjencës, por nuk është përjashtuar asnjëra nga këto mundësi.

Marr për bazë dekaltrat e të dëmtuarit-dëshmitarit F. Xh. dhe dëshmitarit E. Gj., dhe deklaratimet edhe të Dr.Naim Uka dhe Dr.Artan Haxhiu, gjykata kokludon – kosntaton përsëri faktin se i dëmtuari është goditur nga të dy të akuzuarit me thikë në regjionin e qafës.

Gjykata duke analizuar provat materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor, respektivisht .Raporti i këqyrjes se vendit ngjarjes i dt. 07.02.2021, ka arritur të kosntatoj vetëm faketet tani jo-kontesutese ku është kosntaruar vendi se ku ka ndodhur ngjarja, e që vendi ku ka ndodhur ngjarja është rruga “//” në D.. Tutje nga raporti i vendit të ngjarjes janë kosntatuar edhe pika gjaku e që tani nuk është kontesutes fakti se i dëmtuari F. Xh. ka pësuar lëndime me gjakëderdhje në regjionin në qafë. Një pasqyrim i tillë kosntatohet edhe nga prova tjetër materiale e administruar në shqyrtimin gjyqësor – fotoalbumi i vendit të ngjarjes i shoqëruar edhe me fotografitë e tjera përcjellëse.

Sa i përket ekspertizës mjeko-ligjore për lëndimet e te dëmtuarit F. Xh., ekspertiza e datës 13.03.2021 në të është kosntatuar se: i dëmtuari ka pësuar lëndime të rënda trupore, plagë prerëse në regjionin e qafës, enfizem e lehtë subkutane, prishje e kontunitetit të indeve të buta, submandibullare të qafës dhe skajit të poshtëm të gjandres pshtymore submandibullare të majtë, lëndime këto të shkaktuara si rezultat i veprimit mekanik të mejtit të fortë dhe të mprehtë. Gjykata ia ka falur besimin në tërësi kësaj ekspertize dhe është në prputhje edhe me deklaratimet e Dr.Naim Uka të dhëna në sencën e shqyrtimit gjyqësor, ndërsa sa i përket deklaratimit të Dr.Naim Uka sa i përket çështjeve kontesutese – se sa goditje i ka pësuar i dëmtuari, kjo gjykatë veç se ka dhënë arsyetimet përgjatë elaborimit të deklartës së Dr.Naim Uka e do të trajtohet edhe njëhere tek nxjerja e përdundimeve - kosntarimeve.

Sa i përket Flete lëshimit të datës 08.02.2021 qe korrespondon me hospitalizimin e te dëmtuarit me datë. 08.08.2021, numri i historisë 71/32, për këtë çështje gjykata e ka ftuar Dr.Artan Haxhiun në shqyrtimin gjyqësor e ku sqarimet e tij dhe faktet që janë vërtetuar, gjykata veç se i ka trajtuar më sipër për gjatë hartimit të këtij aktgjykimi, ku janë sqaruar edhe fakti se pse në këtë raport i është referuar vetëm si plagë, e po ashtu gjendjen shëndetësore të pacientit dhe gjitha veprimet që janë marrë në drejtim për të shpëtuar jetën e tani të dëmtuarit.

Gjykata duke i dhënë të drejtë fundamentale barazisë së palëve në procedurë, me prioritet të veçantë ka analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarve H. Sh. e A. B. përkitazi me veprën penale të vrasjes në tentativë, respektivisht faktin se kush e kishte goditur me thikë në në qafë të akuzuarin. Kjo gjykatë fillimisht kosntaton se të akuzuarit janë mbrojtur në heshtje në shqyrtimin gjyqësor, por gjykata ka analizuar dekaltrat e tyre të mëparshme të dhëna në stadet e mëparshme të procedurës. Lidhur me dilemat e praktikës gjyqësore në faktin se deklaratat e dhëna në stadet më të hershme të procedurës tani më e ka determinuar Gjykata e Apelit ku ne vendimet e saja specifikon se këto deklarime nuk e kanë cilësinë e provës së papranueshme.

Në këto rethana për të krijuar edhe një pasqyrë më të qartë lidhur me rastin, gjykata fillimisht kosntaton se të dy të akuzuarit pas rastit për rreth tre ditë kanë qenë në arrati dhe të njejtit janë dorëzuar me datën 08.02.2021 në Polici. Në deklarat e tyre të akuzuarit secili veç e veç kanë pohuar incidentin, por kanë hedhë fajin tek njëri tjetri lidhur me faktin e goditjes me thikë. I akuzuari H. në deklaratën e tij ka deklaruar se ka qenë A. i cili i ka treguar dhe i ka thënë se e ka goditur me thikë të dëmtuarin, ndërsa në të njejtën mënyrë deklaroi edhe i akuzuari A. duke thënë se duke ikur nga vendi i ngjarjes ka qenë H. ai cili i ka thënë se e ka goditur me thikë të dëmtuarin F.. Për më tepër dy të akuzuarit akuzojnë njëri tjetrin se për aq kohë sa kanë qenë në arrati, përmes njerzve kanë kërkuar nga njëri tjetri se kinse mos të tregojnë të vërtetën duke i hedhur fajin njëri tjetrit se kush e kishte goditur me thikë tani të dëmtuarin.

Në këto rethana shihet qartë se secili i akuzuar fillimisht përmes arratisjes e pastaj përmes deklaratave janë munduar ti shmangen përgjegjësisë penale.

Marr për bazë faktin se të akuzuarit janë mbrojtur në heshtje në shqyrtimin gjyqësor dhe se në deklaratat e tyre të mëhershme vetëm kanë hedhur fajin tek njëri tjetri, gjykata nuk i trajtoi këto deklarata në disfavorin e tyre, por të njëjtat nuk kanë argumentuar me asnjë fakt se të njëjtit nuk janë kryes të kësaj vepra penale, madje deklaratat e tyre nuk kanë quar as në ndonjë pistë tjetër hetimesh pasi se të dy të akuzuarit kanë aluduar në njëri tjetrin se janë kryes të veprës penale, andaj edhe kjo gjykatë ka vazhduar ta ketë fokusin e vërtetimit të gjendjes faktike në të dy të akuzuarit, andaj edhe ka ardhur në përfundim se deklaratat e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit F. Xh. dhe deklarata dëshmitarit E. Gj. ishin të vërteta dhe të sakta.

Kjo gjykatë edhe një here specifikon faktin se deklaratat e dhëna më parë nga të akuzuarit nuk i ka marr për bazë me rastin e vendosjes në dëm të tyre, por të njëjtat janë trajtuar vetëm po që se do të ndihmonin në pa-fajësinë e tyre dhe se nuk kanë qenë në asnjë moment deklarime në të cilat gjykata mbështet fajësinë e tyre, e as prova mbi bazën e të cilave gjykata i ka gjetur fajtor.

Provat shtesë që nuk kanë mundur të sigurohen

Gjykata konstaton se në rastin konkret nga rjedha e ngjarjes rezulton se përveç tre të akuzuarve, të dëmtuarit dhe dëshmitarit E. Gj. ka pasur edhe persona tjerë që kanë qenë të përfshirë në këtë rast – po ashtu edhe persona të tjerë që e kanë parë ngjarjen dhe nga deklaratat e të gjithë pjesëmarrësve në procedurë gjykata është munduar të siguroj të dhëna me qëllim që të rritë gamën e dëshmive, por as kush nga të lartcekurit nuk ka arritur të identifikoj ndonjë dëshmitar të radhës, e që rrjedhimisht për kundër përpjekjeve të kësaj gjykate, në këtë çështje penale nuk mund të sigurohen prova shtesë.

Provat shfajësuese dhe Pretendimet e mbrojtjes

Marr parasysht volumin e dëshmive që janë proceduar për gjatë shqyrtimit gjyqësor, jo të gjitha provat kanë pasur rrol vendimtar për të determinuar veprimet e të akuzuarve, andaj gjykata do ti trajtoj – shpjegoj në pika të shkurta edhe këto prova.

Kjo gjykatë specifikon se sikurse deklaratat e dëshmitarëve Sh. S. dhe E. S., të ishin të vetmet prova të administruara në shqyrtim gjyqësor, të njëjtat si të vetme do të lënin mëdyshje në raport me zbardhjen e gjendjes faktike dhe se këto mëdyshje gjykata në kuptim të parimit *in dubio pro reo* do ti interpretonte në favorin e të akuzuarve. Tutje po ashtu po që se këto prova do jepnin indicie tjera se dikush tjetër ka mundur të ishte kryes i kësaj vepra penale, gjykata do ti trajtonte, por në rastin konkret këta dëshmitar ani pse kanë kaluar kah vendi i ngjarjes, nuk kanë arritur ti shohin veprimet e pjesëmarrësve e as momentin kur dhe nga kush e ka goditur me thikë tani i dëmtuari.

Po ashtu mbrojtësit e të akuzuarve secili veç e veç kanë specifikuar se marr për bazë faktin se sipas dëshmitarëve S. dhe E. ka pasur distancë mes të akuzuarve dhe të dëmtuarit, të akuzuarit nuk e kanë kryer këtë veprë penale.

Gjykata konstaton edhe njëherë faktin se i dëmtuari ka specifikuar saktë se kush dhe ku e ka goditur dhe një deklaram identik e ka dhënë edhe dëshmitari E. Gj. në deklaramin e tij në polici në ditën kritike dhe e ka përsëritur të njëjtën në çdo deklaram të tij përfshirë edhe deklaramin e tij pranë këtij trupit gjykues, ndërsa dëshmitarët Sh. dhe E. kanë specifikuar se nuk i kanë parë momentet kritike.

Mbrojta e të akuzuarve po ashtu kishte ngritur çështjen në faktin se Dr.Naim Uka dhe Dr.Artan Haxhiu kanë specifikuar faktin se i dëmtuari ka pësuar vetëm një plagë dhe se nuk mund të vërtetohet se kush e ka shkaktuar këtë plagë.

Gjykata konstaton edhe njëherë faktin se Dr.Artan Haxhiu ka sqaruar se, fakti se në raport është shënuar fjala plagë, nuk është menduar në njëjës se është vetëm një goditje por është trajtuar si plagë pavarësisht goditjeve. Tutje edhe Dr.Naim Uka edhe Dr.Artan Haxhiu kanë specifikuar se në ato momente nuk ka qenë fokusi i mjekëve për të determinuar se sa goditje ka pësuar i dëmtuari, por shpëtimi i jetës së tij dhe secili prej tyre ka specifikuar faktin se nuk mund të përjashtohet asnjëra mundësi se a ka pasur nje goditje apo dy goditje tani i dëmtuari.

Lidhshmëria e provave që gojnë në faktin se të akuzarit H. Sh. e A. B. kanë kryer veprën penale Vrasja në tentativë.

Siç është cekur për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, për gjykatën nuk ka qenë kontestuese fakti se me datë 05.02.2021, rreth orës 12:55 min, në rrugën “I. K.” në D. ka ndodhur një përleshje dhe ku i dëmtuar ka ngelur F. Xh. i cili është goditur me mjet të fortë të mpreht për rreth qafës.

Për gjykatën madje nuk ishte kontestuese as fakti se palgët që ka marr i njejt mund të ishin vdekje-prurese pasi që siç është kosntatuar nga Dr.Naim Uka dhe Dr.Artan Haxhiu, regjoni ku është goditur i dëmtuari e ndajnë vetëm milimetra nga arteria kryesore e cila për fatin e mir të të dëmtuarit nuk është prekur.

Për gjykatën kishte mbetur kontestuese vetëm fakti se kush e ka goditur me thikë tani të dëmtuarin dhe se a ishte goditur një apo dy here me thikë i njejt.

Në bazë të hallkës zingjimore të pa shkëputur të provave të adminustruara në shqyrtimin gjyqësor, kjo gjykatë ka krijuar bindjen se përtej çdo dyshimi të bazuar mirë dhe pa asnjë mëdyshje është vërtetuar se të dy t akuzarit H. Sh. e A. B. e kanë goditur me thikë të dmtuarin dhe kanë ndikuar thelbsisht në shkaktimin e pasojës për arsyet si vijon:

Rrjedha e ngjarjes ka filluar në “/” në K. e D. ku aty kanë qenë duke qëndruar i dëmtuari F. Xh. dhe dëshmitari E. Gj., aty kishte ardhur i akuzuari H.i, ku siç kanë theksuar edhe i dëmtuari F. Xh., por edhe dëshmitari E. Gj., H.i ka filluar të jap indikacione se diqka nuk është në rregullt ku siç kanë specifikuar nga dy të lartcekurit “na ka jap një shikim te mrrolshëm ne drejtim tonin”, pastaj H.i i cili ka qenë vet i treti ka dal nga lokali. I dëmtuari dhe dëshmitari kanë specifikuar se nuk i kanë njohur personat që kanë qenë me H.in, ndërsa tutje H.i ka dal nga lokali diku 4-5 minuta para tyre dhe kur të lartcekurit kanë dal nga lokali për te ecur dhe kenë qenë duke shkuar në drejtim të Stacionit të autobusëve, e kanë parë përsëri H. vet i treti tek kafja “ B.” dhe përderisa kanë qenë duke ecur ne drejtim te stacionit H. në shoqëri me ata persona kane filluar tu vihen pas. Duke ecur rrugës kanë vërejtur se i akuzuari tjetër A. ka qenë me nje grup personash rreth 7 veta, ndërsa H. ka qen ne anën tjetër vet i treti. Nga njëra ane A. me grupin e vet dhe nga ana e tjetër H.i me grupin e vet ua kanë bllokuar rrugën dhe i kanë shti në rreth të dëmtuarin F. dhe dëshmitarin E.. Sipas rrëfimit të të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit F. Xh. dhe dëshmitarit E. Gj., deklarata këto të cilave gjykata ia ka falur në tërësi besimin, H. i ishte drejtuar F.it dhe i ka thënë “ pse ma ke nguc nipin” ndërsa i dëmtuari dhe dëshmitari i kanë thënë cilin nip dhe nuk e dijme se e kemi nguc dikend. Në ato momente H. e ka goditur me shuplak F.in dhe të dy të akuzarit A. dhe H. i kanë nxjerur thikat, një fakt i tillë vërtetohet nga dy deklaratat e të dëmtuarit dhe dëshmitarit. Kur H. e ka nxjerr thikën dëshmitari E. e ka kapur H. dhe i njëjti i ka thënë se lëshomë ose ta nguli edhe ty, ne ato momente dëshmitari e ka lëshuar H., dhe H. ka shkuar ne drejtim te F. dhe e ka goditur me thike ne qafe (këto ishin veprimet e të akuzarit H. Sh.). Sa i

përket të akuzuarit A. B., ka qenë i akuzuari A. i cili i pari e ka goditur me thikë të dëmtuarin F. dhe kjo situatë ka ndodhur kur dëshmitari e ka kapur H., A. ka shkuar ne drejtim te F., dhe ka qen A. i pari qe e ka goditur me thike F.in dhe pastaj menjëherë pas tij pasi që dëshmitari e ka lëshuar H. e ka goditur edhe H. me thikë tani të dëmtuarin. E gjithë ngjarja ka ndodhur për pak sekonda dhe disntanca mes goditjes së A. me thikë dhe H. po ashtu me thikë në drejtim të të dëmtuarit ka qenë pak sekonda, ndërsa në ato momente ka arritur Policia dhe njerz të tjerë ku kanë bër titur “e mytet njerin” duke ju referuar për të dëmtuarin F. dhe kanë bër titur “Policia Policia” dhe kështu turma është shpërnda.

Zingjiri i provave që ka quar tek të akuzuarit H. e A. ka filluar nga deklaratat e dëshmitarit E. Gj. e dhënë në polici ditën kritike e që pastaj ka rezultuar të jetë e identike edhe me vet deklaratat e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit. I dëmtuari dhe dëshmitari E. në asnjë moment nuk kanë përmendur persona tjerë apo nuk kanë pasur dyshime se dikush tjetër ka goditur me thikë të dëmtuarin, që me të drejtë hallka zingjire nuk është shkëputur dhe ka quar në drejtim të të akuzuarve H. e A.. Tutje as të akuzuarit në mbrojtjen e tyre nuk kanë inkrimuar dikë tejtër gjë që do të mund të qonte në pista të tjera të hetimeve apo mëdyshjeve, por të njejt i kanë akuzuar njëri tjetrin. Se mundësia e vetme se të akuzuarit H. e A. kanë mundur ta godasin të dëmtuarin nuk zbehet as nga dëshmitë e dëshpitarëve Sh. S. dhe E. S. të cilët nuk kanë specifikuar se kanë parë dikë tejtër duke goditur me thikë të dëmtuarin F..

Nga të gjitha dëgjimet e dëshpitarëve, në veçanti duke ia falur besimin deklaratës së dëshmitarit E. i cili ka qenë personi i parë në polici që ka rrëfyer ditën kritike dhe nuk ka mundur të jetë i ndikuar-kordinuar nga askush, e po ashtu dekaltratën bindëse të të dëmtuarit-dëshmitarit F., por edhe deklaratat e dëshpitarëve Sh. S. dhe E. S., e po ashtu edhe vet mbrojtjen e të akuzuarve të dhëna në statet e hershme të procedurës, gjykata ka përjashtuar çdo mundësi se ndonjë person tjetër mund të jetë kryes i kësaj vepre penale.

Fakti se të dëmtuarin e ka goditur edhe i akuzuari A. edhe H. me thikë në qafë në vendin e njejtë është vërtetuar nga dekaltratat e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit dhe deklrata e dëshmitarit E.. Dilema se pse në raportet mjekësore është shkruar vetëm fjala plagë që është aluduar në një goditje e ka sqaruar vet Dr.Artan Haxhiu njëri nga përpiluesit e ktij raporti ku ka specifikuar se fakti që ne i referohemi si plagë nuk nënkupton se kemi pasur të bëjmë me një goditje dhe se në rastin konkret primare ka qenë shpëimi i jetës së të dëmtuarit dhe jo çështjet tjera, andaj edhe nuk ka përjashtuar asnjë mundësi se a kanë mundur të jenë një apo dy plagë për më tepër specifikohet se edhe shenjat tek fyti i të dëmtuarit janë si në formë të shkronjës A dhe T e po ashtu plaga ka qenë shum e madhe dhe e gjatë rreth 8cm, andaj nuk mund të aludohet në faktin se nuk kanë mundur të dy ta godasin në vendin e njejtë pasi që palaga ka përfshirë një hapsirë tejet te madhe dhe që shihet edhe në fotografi dhe se palga ka qenë në formë të shkronjës A dhe T. Marr parasyh faktin se vet Dr.Artan Haxhiu ka kosntataur se palaga ka qenë e formuar në shkronjat e lartcekura gjenë mbështejtet të plotë edhe në rrëfimin personal e vizual të të dëmtuarit në shqyrtimin gjyqësor për mënyrën se si e kanë goditu të akuzurit.

Fakti se kirurgët në raste të tilla veprojnë me urgjencë dhe se nuk merren me determinimin e goditjeve e ka specifikuar edhe eksperti mjeko-ligjor Dr.Naim Uka e i cili po ashtu ka specifikuar se nuk e përjashton asnjë mundësi se sa goditje ia kanë shkaktuar plagën të dëmtuarit F..

Nga të gjitha provat e lartcekura lidhshmerisë dhe mos-shkëputjes së kronologjisë prej proves në provë, kjo gjykatë pa asnjë mëdyshje ka nxjerr përfundimet e saj se kryes të veprës penale Vrasja në tentativë kanë qenë pikërisht të akuzuarit H. Sh. dhe A. B. të cilët kanë kontribuar thelbëisht në lëndimet që i ka pësuar i dëmtuari.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprave penale Vrasje në tentativë në bashkëkryerje.

Gjykata ka vlerësuar elementet e veprës penale Vrasje në tentativë në bashkë kryerje nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, për të cilën vepër, janë akuzuar i akuzuari H. Sh. dhe A. B., ashtu që dispozita e lartcekur specifikon si vijon: *Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.*

Në rastin konkret, kjo gjykatë ka konstatuar se veprimet e të akuzuarit bëjnë pjesë në nenin 172 të KPRK-së, respektivisht përmbushin elementet e kësaj veprë penale marrë për bazë faktin se të akuzuarit me qëllim të privimit nga jeta personit tjetër, e kanë goditur secili veç e veç me thikë në qafë të dëmtuarin F. Xh., ku Dr.Naim Uka dhe Dr.Artan Muhaxhiri kanë specifikuar se plagët e marra kanë mundur të jenë vdekje-prurese për faktin se nga vendi ku është goditur i dëmtuari e ndajnë vetëm milimetrat për të prekur arteriet kryesore te cilat do të shkaktonin vdekjen e tani të dëmtuarit.

Neni 28 i KPRK-së përcakton si vijon: *Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale.*

Në rastin konkret të akuzuarit kanë ndërmarr veprime në kryerjen e veprës penale vrasje, pasi që me qëllim të privimit nga jeta të personit tjetër, kishin goditur të dëmtuarin me thika në qafë vetëm pak milimetra larg arteries kryesore, dhe nga lëndimet e marra i dëmtuari ka qenë në rrezik për jetën e tij, por që në rastin konkret i dëmtuari nga plagët e mara nuk ka ndëruar jetë, për çka kjo vepër ka ngelur në tentativë.

Neni 31 i KPRK-së përcakton si vijon: *Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.*

Në rastin konkret kjo gjykatë konstaton se dy persona bashkërisht kanë kryer këtë vepër penale ku kanë kontribuar thellësisht në kryerjen e të njëjtës pasi secili prej tyre e ka goditur me thikë në qafë tani të dëmtuarin.

Kjo gjykatë konstaton se të akuzuarit, kanë kontribuar thellësisht në dëmtimet që i ka pësuar i dëmtuari F. ku me qëllim që të njëjtin ta privojnë nga jeta secili veç e veç e ka goditur me thikë në qafë afër arterieve kryesore, me ç' rast vepra penale ka ngelur në tentativë, andaj kjo gjykatë ka vlerësuar se në tërësi janë përmbushur elementet e veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, për të cilën tani është gjetur të akuzuarit fajtor.

Perfundimet e nxjerra sa i përket veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës për secilin të akuzuar veç e veç.

Siç është specifikuar edhe për gjatë rrjedhës së këtij aktgjykimi, të akuzuarit H. Sh. dhe A. B. secili veç e veç janë akuzuar se kanë mbajtur në pronësi pa autorizim armë, respektivisht nga një thikë mjet i cili ka shërbyer edhe në kryerjen e veprës penale.

Fakti se tani të akuzuarit janë gjetur fajtor se secili veç e veç se kanë goditur me thikë të dëmtuarin, nënkupton edhe faktin se ata pa asnjë mëdyshje tani janë gjetur fajtor se secili veç e veç se kanë mbajtur në posedim edhe armën e ftoftë thikën pa leje përkatëse.

Se të akuzuarit H. e A. kanë psoeduar thika me vete është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit E. Gj. të cilit gjykata ia ka falur në tërësi besimin, i cili ka specifikuar saktë edhe llojin e thikave që ka parë në duaret e të akuzurve duke i përshkruar se ato janë thika të zeza e me teh të gjatë rreth 15-20cm që i quajnë boker dhe patent që hapen me pullë. Një fakt të tillë e ka specifikuar edhe i dëmtuari – dëshmitari F. Xh., pra faktin se të dy të akuzuarit e lartcekur kanë pasë thika në duar. Fakti se edhe i dëmtuari është goditur me mjet të fortë të mprehtë - thikë është kosntatuar edhe nga eksperitza mjeko ligjore për dëmtimet e të dëmtuarit F. Xh. dhe për deri sa gjykata ka kosnratuar se të dy të akuzuarit e kanë goditur me këto thika të dëmtuarin ka qar pa-kosntesuteshëm në përfundimet se të akuzuarit secili veç e veç kanë kryer edhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sa i përket veprës penal Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në nenin 366 paragrafi 1 të KPRK-së është specifikuar si vijon: *Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.*

Në rastin konkret të akuzuari e lartcekur, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët nr.05L-022, secili veç e veç ka pasur në posedim nga një thikë siç quhet patent e cila hapet me pullë me një gjatësi të tehut rreth 15-20 cm dhe se për këto thika të akuzuarit nuk kanë poseduar ndonjë leje përkatëse.

Andaj marr parasysh faktin se të akuzuarin nuk ka pasur leje te posaçme për mbajtjen e këtyre thikave, gjykata konstaton se me veprimet e lartcekura të të akuzuarve, janë përmbushur te gjitha elementet e veprave penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Konstatimi i Gjykatës

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, vlerësimi të tyre veç e veç, si dhe në lidhmëni me njëra tjetrën ashtu siç e përcakton neni 360 paragrafi 2 i KPPRK-së, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: është vërtetuar se të akuzuarit H. Sh. dhe A. B., në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe secili veç e veç veprën penale Mbajtja në pronësi apo posedim të pa autorizuar të armës nga neni 366 paragrafi 1 të i KPRK-së.

Vendimi i gjykatës për ta shpallur të akuzuarit H. Sh. dhe A. B. fajtor për te dy veprat penale.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor si: deklaratat e të dëmtuarit – dëshmitarit – F. Xh., deklaratat e dëshmitarit E. Gj., deklaratat e dëshmitarëve Sh. F. dhe E. F., sqarimet e Dr.Naim Uka dhe Dr.Artan Haxhiu, po ashtu provat materiale:Lista e dëshmive e datës 08.02.2021, Raporti i këqyrjes se vendit ngjarjes i dt. 07.02.2021,Fotoalbumi i

vendit te ngjarjes, Ekspertiza mjeko-ligjore për lëndimet e te dëmtuarit F. Xh. e dt. 13.03.2021, Flete lëshimi i dt. 08.02.2021, Vërtetimi mbi sekuestrimin mbi marrjen e përkohshme te gjësendeve, Fotoalbumet nga vendi i ngjarjes, Flete lëshimi i dt.08.02.2021 qe korrespondon me hospitalizimin e te dëmtuarit me dt. 08.08.2021, nr. i historisë 71/32, duke i analizuar fillimisht secilën veç e veç dhe pastaj të gjitha së bashku, erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formësohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale Vrasje në tentativë për të cilën gjykata i ka shpallur fajtor. Po ashtu në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha tiparet e posaçme që e dallojnë veprën penale Vrasje në tentativë në bashkë kryerje nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së nga veprat tjera penale, ku të lartcekurit këtë vepër penale e kanë kryer me dashje, respektivisht kanë marr aso veprime ku me datë 05.02.2021, rreth orës 12:55 min, në rrugën “I. K.” në D., pas një mosmarrveshje paraprake në mes të akuzuarve H. Sh. dhe A. B. në një rën anë dhe të dëmtuarit F. Xh. në anën tjetër, derisa i dëmtuari – dëshmitari F. Xh. ka qenë me shokun e tij - dëshmitarin E. Xh. duke ecur në drejtim të Stacionit të Autobusave në D., në ato qaste i është afruar i akuzuari H. Sh. i cili e ka ndjekur nga pas nga njëra anë dhe kur ka arritur tek Stacioni i Autobuseve, i akuzuari A. i cili po ashtu ka qenë duke e ndjekur nga ana tjetër, u ka dalur përpara dhe ju ka thënë “F. ndalu” me ç’ rast i dëmtuari F. me dëshmitarin E. janë ndalur dhe kanë filluar të diskutojnë lidhur me një problem, ndërkohë ka mbri edhe i akuzuari H. me 7-8 persona të pa-identifikuar i cili është drejtuar me fjalët: “pse ma ke nguc nipin” dhe e ka goditur me shuplak në fytyrë të dëmtuarin F. i cili është munduar të vetëmbrohet, ndërkohë dëshmitari E. është munduar që ti ndaj dhe e ka kapur të akuzuarin H. i cili e ka nxjerrë thikën dhe deri sa i dëmtuari F. ishte vet dhe duar thatë, fillimisht i pari i akuzuari A. B. ka nxjerrë po ashtu thiken dhe me dashje që ta privoj nga jeta e ka goditur me thikë në qafë të dëmtuarin F., e po ashtu i akuzuari H. pasi që është liruar nga dëshmitari E., me dashje që ta privoj nga jeta e ka goditur po ashtu me thikë në qafë të dëmtuarin F., mirëpo ndërkohë deri sa ishte duke vazhduar perleshja, ka arritur Polocia duke bërë titur, “largoni thikat”, dhe vepra penale ka mbetur në tentativë, ndërsa i dëmtuari ka pësuar lëndime të rënda trupore, plagë prerëse në regjionin e qafës, enfizem e lehtë subkutane, prishje e kontunitetit të indeve të buta, submandibullare të qafës dhe skajit të poshtëm të gjandres pshtymore submandibullare të majtë, lëndime këto të shkaktuara si rezultat i veprimit mekanik të mejtit të fortë dhe të mprehtë.

Kjo gjykatë ka vlerësuar se me veprimet e lartcekura të të akuzuarve, të njëjti në bashkë kryerje kanë kryer veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, dhe pasi që gjeti se të dy të akuzuarit e lartcekur janë penalisht përgjegjës, i shpalli fajtor si në dispozitiv I të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë duke analizuar të gjetuarat nga provat e lartcekura e siç është specifikuar edhe për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, ka nxjerrë përfundimet po ashtu se i akuzuari I akuzuari H. Sh., me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e lartcekur, ka mbajtur në pronësi armën-thikë të tipit patent, e të cilën e ka mbajtur në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët nr.05/L – 022. Po ashtu i akuzuari A. B., me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e lartcekur, ka mbajtur në pronësi armën-thikë të tipit patent, e të cilën e ka mbajtur në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët nr.05/L – 022.

Kjo gjykatë ka vlerësuar se me veprimet e lartcekura të të akuzuarve, të njëjti secili veç e veç kanë kryer veprën penale Mbajtja në pronësi apo posedim të pa autorizuar të armës nga neni 366 paragrafi 1 të i KPRK-së, dhe pasi që gjeti se të dy të akuzuarit e lartcekur janë penalisht përgjegjës, i shpalli fajtor si në dispozitiv II dhe III të këtij aktgjykimi

Vendimi mbi sanksionin penal per të akuzuarit H. Sh. dhe A. B.

Me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform neni 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata fillimisht përcakton se rrethanat në të cilat është kryer kjo veprë penale, mënyra e sjelljes së të dy të akuzuarve H. Shalës dhe A. B.t qoftë para veprës penale pasi që secili nga ta ka nga dy aktgjykime të formës së prerë të shqiptuara (edhe pse kjo gjykatë nuk i morri për bazë në përcaktimin e dënimit pasi që koha kur të akuzuarit i kanë kryer këto vepra penale kanë qenë të mitur), e po ashtu edhe sjelljet e tyre pas veprës penale kanë qenë identike, sepse të dy të akuzuarit kanë thyer masat e arrestit shtëpiak, nuk janë penduar për veprimet e tyre, sepse kanë mohuar në vazhdimësi fajësinë, e për më tepër edhe veprimet e tyre në kontributin e veprës penale kanë qenë të njëjta, andaj në këto rrethana gjykata do të trajtoj në mënyrë identike këto reshna për të dy të akuzuarit pasi që nuk gjene dallime substanciale në karakteristikat e të njëjtëve e po ashtu edhe në kontributin e kryerjes së veprës penale.

Gjykata siç edhe u elaborua më sipër nuk gjeti rrethana posaçërisht lehtësuese për të akuzuarit, për veç faktit se të njëjtit janë të një moshe relativisht të re dhe se gjykata është munduar që të njëjtëve tu përcaktoj një sanksion penal që mund të përkoj me rehabilitimin e tyre dhe të njëjtit pas vuajtjes së dënimit të kthehen si anëtarë të denjë të shoqërisë.

Si rrethanë rënduese, gjykata mori për bazë shkallën e lartë të dashjes të kryesit në kryerjen e veprës penale, për faktin se të akuzuarit nuk kanë hequr dorë nga qëllimi për ta privuar nga jeta tani ë dëmtuarin dhe sipas deklaratës së të vet të dëmtuarit, por edhe nga deklaratata e dëshmitarit E. Gj., të dy të akuzuarit kanë tentuar përsëri ta godasin F., por për fatin e tij ka ndërhyrë Policia dhe të akuzuarit kanë ikur nga vendi i ngjarjes.

Si rrethanë rënduese gjykata morri për bazë edhe faktin se të akuzuarit asnjëherë nuk kanë shprehur pendesën për rastin që ka ndodhur.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave rënduese të elaboruara sipër, të akuzuarve secilit veç e veç për veprën penale të Vrasjes në tentativë u shqiptoi dënim me burgim, duke përcaktuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vite burgim efektiv, i cili dënim do të ekzekutohet në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

Sa i përket veprës penale të Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar nga neni 366 par 1 të KPRK-së, siç është specifikuar edhe më sipër, të akuzuarit secili veç e veç ishin gjetur fajtor edhe përkitazi me këto vepra penale. Gjykata trajtoi te njëjtat rrethana rënduese për të akuzuarit si për veprën penale të lartcekur. Gjykata në rastin konkret arsye se pse vendosi që edhe për këtë veprë penale secili veç e veç të dënohen me nga 3 muaj burgim efektiv, është për faktin se gjykata morri si rrethanë rënduese faktin se pikërisht nga posedimi i këtyre thikave pa autorizim në kontest të përgjithshëm në shoqërinë tonë po vijnë deri te këto raste, e marr për bazë rastin konkret, të akuzuarit kanë poseduar pa autorizim armën dhe me këto armë kanë kryer edhe therjen e tani të dëmtuarit.

Gjykata u kishte dhënë mundësi palëve, respektivisht i kishte informuar për të drejtën e tyre për të propozuar caktimin e seancës nga neni 356 i KPRK-se, ku do të trajtoheshin rrethanat për shqiptimin e dënimit, por palët kishin konsideruar se i kanë specifikuar te gjitha çështjet dhe nuk kishin propozuar një seancë të tillë dhe kishin kërkuar nga gjykata që të procedohet tutje.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të elaboruara sipër, të akuzuarve fillimisht u përcaktoi dënimin për secilën veprë penale veç e veç të përcaktuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe duke zbatuar dispozitat e nenit 76 të KPRK-së të akuzuarve secilit veç e veç u shqiptoi dënim unik me burgim, duke përcaktuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) vite e një (1) muaj burgim efektiv i cili dënim do të ekzekutohet në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e shqiptimit të sanksionit penal, mori për bazë edhe udhëzuesin e politikës ndëshkimore të lëshuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, që ka për qëllim unifikimin e politikës ndëshkimore, me theks të veçantë kritiken për dënime jo adekuate.

Duke ju referuar udhëzuesit të lartcekur, i njëjti ka specifikuar se gjykata në raport me matjen e dënimit duhet të ketë një pikënisje dhe pastaj varësisht nga rrethanat rënduese ose lehtësuese do të lëvizet në diskrecionin e gjykatës për të arritur në një dënim të drejtë. Në rastin konkret në matjen e dënimit, gjykata duke zbatuar udhëzuesin sqaron se tek vepra penale e Vrasjes e paraparë me nenin 172 të KPRK-së është përcaktuar si masë më e ulët dënimi në kohëzgjatje prej 5 vite, ndërsa nuk është përcaktuar maksimumi i dënimit e që nënkuptohet maksimumi i përgjithshëm që rezulton të jetë 25 vite. Ndërsa sa i përket veprës penale të Mbjajtjes në pronësi të pa autorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së nuk është përcaktuar dënimi e që nënkuptohet minimumi i përgjithshëm i dënimit pra 30 ditë burgim, ndërsa maksimumi i dënimit është 5 vite burgim. Në rastin konkret gjykata vlerëson se pikënisja për këto vepra penale duhet të jetë mesatarja e këtij dënimi dhe marr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese pastaj gjykata lëviz në diskrecionin e saj për të arritur deri tek një dënim meritore dhe i drejtë. Gjykata konsideron se në rastin konkret në bindjen e kësaj gjykate kanë mbizotëruar rrethanat rënduese marr parasysh rrethanat e rastit faktik dhe karakteristikat e të akuzuarve dhe sjellët e tyre para dhe pas veprës penale e të cilat i ka elaboruar më sipër kjo gjykatë.

Megjithatë marr për bazë faktin se për këto vepra penale parashihet dënime bukur të larta, kjo gjykatë duke marr për bazë edhe moshën e të akuzuarve është mundur të përcaktoj një dënim unik me burgim i cili përfundimisht do të përçojë mesazh të qartë tek të akuzuarit lidhur me pasojat që përkon sanksioni penal me veprimet e tyre inkriminuese, por gjithherë duke ju dhënë edhe mundësi rehabilitimi, andaj edhe kjo gjykatë lëvizi drejt minimumit të dënimit, por me bindje të plotë se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata vlerëson se zbatimi i udhëzuesit të lartcekur në matjen e dënimit është i domosdoshëm, për të shqiptuar një sanksion të drejtë penal, e mbi të gjitha për të krijuar siguri juridike tek qytetarët, si dhe idenë e qartë se si vihet në mënyrë të drejtë deri tek dënimi i merituar.

Siç është theksuar edhe më sipër, marr parasysh mungesën e rrethanave lehtësuese në rastin konkret dhe mbizotërimin e atyre rënduese, gjykata ka mundur të shqiptoj sanksion edhe më të rëndë penal. Megjithatë, kjo gjykatë konsideron që ky dënim është adekuat që të akuzuarit ta kuptojnë rëndësinë e veprës penale që e kanë kryer e po ashtu edhe rëndësinë që ka për pasojë sanksioni penal.

Gjykata ka bindje se me këtë dënim, respektivisht dënimin me burgim të përcaktuar si në dispozitivin e aktgjykimit, kryesi i veprës penale, në rastin konkret të akuzuarit H. Sh. dhe A. B., do ta kuptojnë rëndësinë e veprës penale të cilat i kanë kryer në ditën kritike dhe në këtë mënyrë të njëjtit do të reflektoj që në të ardhmen mos të shkaktojnë veprime të ndaluara, përkatësisht mos të kryejnë veprë penale, e çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së. Gjykata ka bindjen se një dënim i tillë është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën

e përgjegjesisë të të akuzuarve dhe se gjykata vlerëson se me dënimin e lartcekur me burgim do të arrihet qëllimi i këtij dënimi.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Llogaritja e kohës së kaluar nën masën e ndalimit në dënimin e shqiptuar

Neni 79 paragrafi 1 i KPRRK-së përcakton se: “Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, burgim për të mitur, në masën edukative institucionale dhe dënimin me gjobë. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, gjykata ka bërë llogaritjen e kohës së kaluar nën masën e paraburgimit dhe të arrestit shtëpiak për të akuzuarit H. Sh. dhe A. B. ku kohë e kaluar nën këto masa nga data 08.02.2021 e tutje do tu llogaritet të njëjtëve në dënimin e përcaktuar me burgim, ashtu siç e është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës për të akuzuarit H. Sh. e A. B.

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 453 paragrafi 1 i KPRRK-së ka vendosur edhe për shpenzimet e procedurës. Në këtë drejtim, gjykata i obligoi të akuzuarit që secili **veç e veç** që konform nenit 449 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 të KPRRK-së, të paguaj shumën prej **200€ (dyqind euro)**, në emër të paushallit gjyqësor dhe këtë gjykata e vlerësoi për shkak të vajtje ardhjeve të shumta të të akuzuarve nga qendra e praburgimit. Po ashtu, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata po ashtu obligoi të akuzuarit secilin **veç e veç** të paguaj shumën prej **50€ (pesëdhjetë euro)**, në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Lidhur me shpenzimet tjera eventuale gjykata do të vendos me aktvendim të posaçëm pas përllogaritjeve të kësaj gjykate.

Gjetjet e gjykates në raport me të akuzuarin A. B.

Në vazhden e arsyetimit të këtij aktgjykimi, gjykata në këtë pjesë të arsyetimit do të i analizoj vetëm veprimet e të akuzuarit A. B. në drejtim të veprës penale për të cilën akuzohet.

Kjo gjykatë me kujdes ka anlizuar edhe provat personale, respektivisht dëgjimin e dëshmitarëve të cilët kanë specifikuar veprimet e tani të akuzuarit A. B.. Gjykata objekt shqyrtimi për të akuzuarin A. ka pasur të vërtetoj faktin po që se i njëjti është përfshi ose jo në rrahje.

Nga deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit F. Xh., gjykata ka arritur të vërtetoj faktin se edhe i akuzuari A. është përfshirë në rrahje dhe se e ka goditur me grushte tani të dëmtuarin. Siç është specifikuar më sipër, gjykata ia ka falur në tërësi besimin deklaratës së të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit, sepse e njëjta deklaratë ka qenë e pa ndryshuar në esencë gjatë gjitha deklaratave e për më tepër ka qenë në përputhje edhe me provat tjera qoftë personale qoftë materiale, ndërsa në rastin konkret sa i përket të akuzuarit A., deklarata e të dëmtuarit është në përputhje të plotë edhe me deklaratën e dëshmitarit E. Gj..

Dëshmitari E. Gj., i cili ishte dëshmitari i vetëm okular, po ashtu ka specifikuar se e ka parë të akuzuarin A. duke shkuar në drejtim të të dëmtuarit dhe se e ka parë kur i akuzuari A. e ka goditur F.in me grushte.

Siç është specifikuar edhe përgjatë arsytimit të këtij aktgjykimi, dëshmitari E. Gj. ka pasur peshë të posaçme për gjykatën në zbardhjen e gjendjes faktike, për faktin se i njejtë ka qenë dëshmitar okolar dhe se dëshminë e tij e ka dhënë edhe pranë policisë ditën kritike dhe dëshmia e tij nuk ka pasur ndryshime për gjate deklarimeve të cilat do të zbehnin kredibilitetin e tij e për më tepër çdo deklaratë e tijë ka gjetur përputhje në të gjitha provat tjera, ndërsa sa i përket veprimeve të akuzuarit A., deklaratat e dëshmitarit përputhet në mënyrë identike me deklaratën e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit, andaj të njejtës deklaratë gjykata ia fali në tërësi besimin. Dëshmitari Sh. F. ka deklaruar se se ka parë fare të akuzuarin A., ndërsa dëshmitari E. F. konfirmon se e ka parë të akuzuarin A. në turmë dhe ka theksuar se i njejtë ka shkuar për ti ndarë të përfshirët në përleshje. Andaj, fakti se i akuzuari A. ka qenë i përfshirë aty konformohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit E. F., ani pse i njejtë thekson se i akuzuari A. ka dashur ti ndajë të tjerët, por kjo gjykatë tërheq vëmendjen se vet dëshmitari Eron ka specifikuar se ka qenë aç tollovi e madhe sa nuk ka arritur ti shoh veprimet e të gjithë pjesëmarrësve që rjedhimisht nuk ka mundur ti shoh as veprimet e tani të akuzuarit A..

I akuzuari A. në mbrojtjen e tij është mbrojtur në heshtje.

Duke u bazuar në lidhshmërinë dëshmitarëve të lartcekur dhe mbi argumentet e arsyetuar më sipër kjo gjykatë ka nxjerrë përfundimin se i akuzuari A. është përfshirë në rrahje dhe se e ka goditur me grushte të dëmtuarin F. Xh..

Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprave penale Pjesëmarrje në rrahje.

Gjykata duke vlerësuar elementet e veprës penale të Pjesëmarrjes në rrahje nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së, konstaton se në këtë dispozitë është specifikuar si vijon: *Kushdo që merr pjesë në rrahje, e cila rezulton me vdekje ose lëndim të rëndë trupor të personit, për pjesëmarrje në rrahje dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet.*

Në rastin konkret nga provat e administruara është konstatuar se i dëmtuari F. Xh. ka pësuar lëndime të rënda trupore, ndërsa gjykata po ashtu ka vërtetuar faktin se i akuzuari A. B. është përfshirë në rrahje dhe ka marr pjesë duke e goditur me grushte tani të dëmtuarin.

Në këto rrethana kjo gjykatë ka konstatuar se i akuzuari A. B. me veprimet e tija ka konsumuar në tërësi elementet e veprës penale Pjesëmarrjes në rrahje nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së.

Konstatimi i Gjykatës

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, vlerësimit të tyre veç e veç, si dhe në lidhmëni me njëra tjetrën ashtu siç e përcakton neni 360 paragrafi 2 i KPRK-së, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: është vërtetuar se i akuzuari A. B., ka kryer veprën penale Pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Vendimi i gjykatës për ta shpallur të akuzuarin A. B. fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor si: deklaratën e të dëmtuarit – dëshmitarit – F. Xh., deklaratën e dëshmitarit E. Gj., deklaratat e dëshmitarëve Sh. F. dhe E. F., duke i analizuar fillimisht secilën veç e veç dhe pastaj të gjitha së bashku, erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale Pjesëmarrja në rrahje për të cilën gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin. Po ashtu në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha tiparet e posaçme që e

dallojnë veprën penale Pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së nga veprat tjera penale, ku i lartcekuri këtë vepër penale e ka kryer me dashje, respektivisht ka marr aso veprime ku I akuzuari A. B.ka marr pjesë në rrahje që ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor të të dëmtuar-dëshmitarit F. Xh., në atë mënyrë që me datën dhe vendin e përcaktuar si në dispozitivët e lartshënuar, pas një mosmarrëveshje paraprake në mes të akuzuarve H. Sh. dhe A. B. në një anë dhe të dëmtuarit F. Xh. në anën tejtër deri sa të akuzuarit, i dëmtuari dhe persona të tjerë të pa identifikuar ishin duke u perleshur mes vete dhe i dëmtuari ishte i goditur me thikë nga të akuzuarit e lartcekur, në rrahje ka marrë pjesë edhe i akuzuari A. B. i cili e ka goditur me grushte të dëmtuarin F. Xh..

Vendimi mbi sanksionin penal per të akuzuarit H. Sh. dhe A. B.

Me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata po ashtu as për të akuzuarin A. nuk gjeti rrethana posaçërisht lehtësues, ndërsa si rrethanë rënduese morri për bazë gjendjen e gjakosur në të cilën ka qenë i dëmtuari F. kur i akuzuari A. e ka goditur me grusht. Si rrethanë rënduese gjykata morri për bazë edhe dënimet paraprake të të akuzuarit A. që janë konstatuar me aktgjykime të plotfuqishme, por të cilat marr parasysh periudhën e cila ka kaluar nga aktgjykimet paraprake deri në momentin e kësaj vepre penale, për gjykatën të njëjtat nuk ishin determinuese.

Megjithatë, marr parasysh peshën e veprës penale për të cilën është akuzuar tani i akuzuari A. dhe mënyrën e shpejtë në të cilën ka ndodhur ngjarja, gjykata i përcaktoj afërsisht mesataren e dënimit të akuzuarit, pra në kohëzgjatje prej një viti burgim, por duke i dhënë një mundësi të njëjtit që ky dënim mos të ekzekutohet, në rast se i njëjti nuk kryen vepër penale në periudhën kohore dy vjeçare.

Kjo gjykatë konstaton se tani i akuzuari ka arritur të kuptoj pasojën që ka sanksioni penal në kuptim të veprimeve të tija dhe tani është mëse i vetëdijshëm se në rast të mos-respektimit të dënimit me kusht, i njëjti do të vuan këtë dënim dhe pastaj do të dënohet edhe për vepër të re penale.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit për të akuzuarin A. B., është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 te KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës per te akuzuarin A. B.

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 453 paragrafi 1 i KPPRK-së. Në këtë drejtim, gjykata e obligoi të akuzuarin që konform nenit 449 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 të KPPRK-së, të paguaj shumën prej **50€ (pesëdhjetë euro)**, në emër të paushallit gjyqësor. Po ashtu, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimet, gjykata e obligoi të akuzuarin të paguaj shumën prej **50€ (pesëdhjetë euro)**, në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimet.

Lidhur me shpenzimet tjera eventuale gjykata do të vendos me aktvendim të posaçëm pas përllogaritjeve të kësaj gjykate.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Gjykata konstaton se përfaqësuesi i të dëmtuarit Avokat Gazmend Halilaj e po ashtu edhe i dëmtuari F. Xh. kanë specifikuar se rezervojnë të drejtën e tyre për të paraqitur kërkesën pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko civil, andaj kjo gjykatë konform nenit 462 paragrafi 2 të KPPRK-së, të lartcekurit lidhur me kërkesat e tyre i udhëzoi në kontest të rregullt juridiko-civil, ashtu edhe siç është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 360 dhe 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJKYATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.361/21 datë 27.06.2023

Kryetari i trupit gjykues
Ngadhjim Arrni

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.